

NGA PËRMBLEDHJA RISALE-I NUR

BEDIÜZZAMAN SAID NURSI

PROFETI MUHAMMED
(A.S.M.)
DHE RRUGA E TIJ

Botimi i tretë



Said Nursi

PROFETI MUHAMMED (A.S.M.) DHE RRUGA E TIJ

Parathënie

Ftesa për të hartuar një parathënie të botimit shqip të veprës “Profeti Muhammed (a.s.m.) dhe vepra e tij”, të autorit të famshëm Bediüzzaman Said Nursi, më erdhi e papritur. Unë mësuesi i vjetër i një vendi të largët, me një jetë plot zigzake e vështirësi, disi i topitur dhe i hutuar, mendova se kërkesa ishte drejtuar gabim. A jam i denjë unë të shkruaj për një vepër të Said Nursiut, fjalët dhe mendimet e të cilit plot urti qiellore, duhet t’i përsërisësh disa herë që t’i kuptosh? A jam i aftë unë të parashtoj mendime për Profetin tonë të dashur, të cilit i kanë thurur vargje poetët më të shquar të shekujve, e kanë vlerësuar filozofët më të mëdhenj të kohërave dhe dijetarët më të nderuar të botës!

Ftesa duhej pranuar qoftë edhe si shenjë nderimi që më bëhej.

I dashur lexues, këto fjalë ndoshta do të duken disi të tharta si ato frutat e papjekura, por dije mirë se janë fjalë zemre që gufojnë nga dashuria për All-llahun xh.sh. dhe të Dërguarin e Tij, Muhammedin (a.s.m.). Unë kam lexuar shumë biografi të Hz. Muhammedit (a.s.m.), kam studiuar me hollësi të gjitha mevludet e shkruara në gjuhën shqipe për Profetin tonë Fisnik. Të gjitha më janë dukur të bukura, secila vepër ka vlerën e vet njohëse dhe edukuese, por tek Said Nursiu, Profeti Muhammed (a.s.m.) paraqitet me një mënyrë krejt tjetër. Këtu nuk kemi një biografi të mirëfilltë, as hymne lavdëruese me fjalë poetike. Jo, tashmë autori me një aftësi të jashtëzakonshme analizuese dhe përgjithësuese, si një filozof i përsosur e paraqet Profetin tonë të nderuar në pamjen e plotë të së vërtetës islame, e vërtetë që buron nga Drita Hyjnore, nga Kur’ani famëlartë, nga fjala, sjellja dhe vepra e ndritur e Profetit (a.s.m.).

O lexues i nderuar, mbrehe veshin tënd e dëgjo mirë, kthjelloje vështrimin tënd e shiko mirë, gjallërohu e vështro në librin e madh të gjithësisë, këtu do të gjesh të vërtetat e larta që t’i mëson Risale-i Nur. Autori me të drejtë thotë: “Fjalët janë shumë të bukura, por ato i kanë zbukuruar edhe më shumë cilësitë e Muhammedit (a.s.m.)”. Ndërsa unë më mirë po hesht. Po ia lë radhën fjalëve të plakut të urtë, Saidit të ditur. Ky si një filozof i lashtë e vështron botën me të gjitha bukuritë dhe hijeshitë, që si në një sipërfaqe uji të kulluar, pasqyrohen Emrat e Bukur të Përsosmërisë së Krijuesit.

Nursiu me fantazinë e tij krijuese, na çon në Gadishullin Arabik. Atje flet ai, Vula e profetëve, imami i të gjithë besimtarëve, me një zë madhështor kumton: “S’ka Zot tjetër përveç All-llahut”. E këtë e dëshmojnë miliona besimtarë të shpërndarë në të gjithë botën

që si në një kor madhështor gjëmon në veshin e së ardhmes “La ilahe illall-llah”. Dëshmia shumëfishohet në shifra marramendëse të një miliard e gjysëm besimtarësh islamë të të gjitha racave, kombësive dhe shtresave shoqërore.

Dhe e gjitha kjo lidhet me personalitetin e dëshmuesit të parë, mësuesit dhe edukatorit të parë islam, Muhammedit (a.s.m.). Po cilat janë cilësitë themelore të këtij thirrësi reformator?

Imagjinoni Hz. Muhammedin (a.s.m.) në minber. Ai ka marrë në dorë Kur’anin e madhnueshëm dhe sqaron sekretet e çuditshme: “Çfarë je? Nga vjen? Ku po shkon?” Ai zotëri e sqaron këtë problem që ka turbulluar mendjet e dijetarëve më të shquar të botës, me përsosmëri e përpikmëri. Ai përhap dritën e së vërtetës, shpallë fenë islame, përmend emrin e Krijuesit të të gjitha qenieve, me të gjithë forcën e fesë së tij. Kjo dritë e shenjtë vendosi paqen e harmoninë midis qenieve, shpërndau frymën e miqësisë dhe të vëllazërimit. Ardhja e fesë e lartësoi njeriun në rangun më të lartë ndaj të gjitha krijesave dhe e shndërroi në një “mbret nazik dhe të zgjuar”, siç thotë Nursiu. Këtë të vërtetë ka mundur ta sqarojë vetëm një person i famshëm, dhe ai është Hz. Muhammedi (a.s.m.). Ai është zbuluesi dhe soditësi i thesareve hyjnore, ai është një shembull i përsosur i dashamirësisë dhe i mëshirës, ai shëmbëllen si një ylber që ndriçon punën e Krijuesit të gjithësisë, ai është një argument i drejtësisë dhe si një Dritë e Diellit për udhërrëfyesin. Ai është një mundësi shpëtimi. Jo me tirani, por me bindje ai u pushtoi mendjet, zemrat dhe shpirtrat e njerëzve. Ai u bë i dashuri i zemrave, mësuesi i mendjeve, pastruesi i nefseve dhe analizuesi i shpirtrave.

Lexues i dashur, vështro pak në atë kohë të artë. Profeti ynë shumë tradita të lashta të ngulitura fort në popuj, në një kohë fare të shkurtër, ka mundur t’i shkulë, duke mbjellur në vend të tyre cilësitë më të bukura. Ai mundi që ata njerëz të egër dhe injorantë, t’i kthejë në mësues dhe mjeshtër për të edukuar popujt e tjerë. Duke pohuar këtë veprë madhështore edukative, Said Nursiu gufon: “Le të ngrihen dhe të shkojnë atje me qindra filozofë dhe le të punojnë 100 vjet, përsëri një për qind të veprave të Profetit Fisnik, nuk mund t’i realizojnë (megjithëse ai nuk ka ditur as të shkruajë as të lexojë)”.

A nuk shihni sot se ç’luftë bëhet kundër përdorimit të drogës, alkoolit, duhanit, kumarit, prostitucionit, etj. plagëve të rënda shoqërore! Cili shtet apo superfuqi ka mundur që t’i nënshtrojë? Cili reformator dhe edukator sot mund t’i përballojë? Këto plagë shoqërore po rriten e po rriten e janë bërë një dënim për shoqërinë që i mbars dhe i ushqen. E krahasojë këtë me veprën e pashembullt të Profetit Muhammed (a.s.m.). Profeti është kthyer nga “Arshi i Madh” me duart e ngritura dhe bën dua, lutet me zërin e tij që gjëmon në të gjitha kohërat dhe e dëgjojnë të gjitha qeniet. Gjatë të gjithë jetës së këtij Fisniku të devotshëm me lutjen e vet ai kërkon lumturinë e përjetshme në parajsën e lumtur, në takimin me të Madhin Zot.

Të gjithë poetët për të argumentuar këtë kanë trajtuar tre momente të jetës së Profetit (a.s.m.), lindja, miraxhi dhe ndërrimi jetë. Amineja e sheh të birin e vet të sapolindur në sexhde duke mërmëruar: “Va ymmeti, va ymmeti”. Prandaj poeti këshillon:

“Aj e lyp ymmetin tuj qen’ fëmij,
e ti tuj qen’ plak, e len rrugën e Tij”.

Në miraxh, në audiencën madhështore, para All-llahut, ai Fisnik kërkon vetëm një gjë: mëshirë e shpëtim për ymmetin, kërkon lumturinë e përjetshme, parajsën e amshuar.

Në çastet e ndërrimit jetë, kur engjulli “që merr shpirtat”, Azraili është tek shtrati, ai Zotni lutet që të ketë kujdes ymmetin. Për këtë poeti shkruan:

“Ja Azrail, un ke ti kam një rixha:
– Ymmetit’Em, kur t’i vish, fort me kadal,
shpirtin e atyne me t’mir’ me m’iu marr.
Zahmetin e ymmetit t’Em Mu ma jep,
mos me m’i dhanun Ti zor, ban rahmet!
Zorin e tyne Un e hjek, po ndigjo!
Ja Azrail prej Teje s’due tjetër gjë”.

A vini re se mëshira dhe dituria e kulluar, Drejtësia Absolute vetëm nga lutja e të Dërguarit, Muhammedit (a.s.m.) do të kishte krijuar lumturinë e përjetshme, parajsën.

Nga sa thamë Said Nursi arrin në dy konkluzione me vlerë:

Së pari Pejgamberia e Muhammedit (a.s.m.) është një arsye, është një shkak për të sqaruar se kjo jetë është një vend prove, ku njeriu me bindjen e tij e me liri të plotë zgjedh rrugë e tij. E Profeti për këtë është dërguar, për t’u treguar njerëzve rrugën e drejtë, është dërguar si mëshirë dhe si edukator i njerëzimit.

Së dyti, lutja e Profetit, ibadeti i tij i ndjekur nga miliona besimtarë, është një arsye e qartë për sqarimin e jetës së lumtur në botën tjetër. Çdo gjë që na rrethon është krijuar me një bukuri të pashoqe. “Kjo gjithësesi nuk kishte mundësi të ishte më e mirë se kaq”. Edukata e Krijuesit nuk pajtohet me të shëmtuarën dhe çrregullimin. Ashtu si krijoi çdo krijesë me përsosmërinë më të madhe, Ai Krijuesi i Plotfuqishëm, do të pranojë lutjen e Ringjalljes dhe të Lumturisë së Përjetshme. E kjo është e lehtë për Krijuesin, i Cili sjell pranverën dhe ripërtërin çdo gjë në cikle të rregullta, pa as më të voglën vështirësi.

•

Në pjesën e dytë të veprës kumtohet ky mesazh themelor: “O njeri, në se do të ngrihesh në lartësinë e duhur, në se do të fitosh dashurinë e mëshirën e All-llahut të Madhërueshëm, ndjek rrugën e Pejgamberit (a.s.m.). Në se e doni All-llahun, atëhere ejani pas meje, që All-llahu t’ju dojë.”

Sot kemi arritur në kohë të vështira, sidomos në vendin tonë shumë veprojnë në kundërshtim me rrugën e All-llahut, prandaj marrin kuptim të veçantë fjalët e Profetit: “Në kohën kur njerëzit e lënë rrugën time (sunnetin), kush e vazhdon atë ka fituar sevapin e një qind shehidëve”.

Pikërisht për këtë ka rëndësi fjala e Plakut të urtë, Said Nursiut: “Në këtë moment të përjetosh një cilësi sado të vogël të Pejgamberit, është një devotshmëri e madhe, e cila tregon një besim të fortë”. Kjo të kujton All-llahun e të kthen në praninë e tij. Edhe punët më të vogla e të zakonshme, mund të sjellin shpërblime. Kush i mbështetet sunnetit dhe këtë ia bën zakon vetes, atëhere edhe veprimet më të thjeshta të përditshme, i shndërron në adhurim, kështu të gjithë jetën e vet njeriu e mbush me mirësi (sevape). Lidhur me këtë Nursiu nxjerr një mësim nga jeta e vet:

“Pikërisht unë Saidi i varfër, në çastin kur u shkëputa nga Saidi i moçëm, kur ende ndodhesha në mes të një stuhije të tmerrshme shpirtërore, me kryelartësinë e nefsit që më kishte gllabëruar, nuk e kisha gjetur akoma rrugën e vërtetë, por me mendje dhe zemër luftoja dhe e kërkoja vazhdimisht këtë rrugë. Në ato momente nganjëherë ngrihesha lart, e nganjëherë zhytesha në humnerë, në thellësira të tmerrshme. Pikërisht kur isha në këtë përshtjellim të tmerrshëm, e pashë se çështjet e sunnetit të Pejgamberit, bile me disa përpjekje të vogla, duhej t’i ndiqja, sepse ishin si busulla të drejtimit të anijes... duke u mbështetur tek sunneti i Pejgamberit gjeja qetësi. Çuditërisht shtrengimet më largoheshin, rrugët më ndriçoheshin dhe më krijohej bindja se po lëvizja nëpër një rrugë të mbarë dhe të sigurtë”.

Në të gjitha kohërat në fushë të edukatës një rol të veçantë ka luajtur shembulli i mirë. Një prind i mirë, një vëlla apo motër e mirë, një shok apo mik i mirë, ka qenë gjithnjë një faktor me vlerë edukimi. Po mendoni ç’vlera edukimi në të gjitha qelizat e jetës materiale e shpirtërore të njeriut, luan Profeti Muhammed (s.a.s.). Ai është një shembull i lartë edukate. Ai është shëmbëlltyrë e njeriut të lartë, sepse ai jetimi i gjorë, mbeti pa nënë e baba, për t’u interesuar për të Vetë i Gjithëmëshirshmi. I Dërguari Fisnik ka thënë: “Mua All-llahu xh.sh. më ka edukuar me sjelljet më të bukura”.

Kush ka lexuar jetën e tij, kush ka studiuar sunnetin e tij, me të vërtetë e ka kuptuar se të gjithë moralin e lartë All-llahu e ka përdorur në të Dashurin e Tij. Kush braktis sunnetin e Muhammedit (a.s.m.), ai patjetër ka humbur moralin dhe do të përballet me këtë mësim themelor: “I pasjellshmi bëhet i vobeghtë prej mëshirës së All-llahut xh.sh.”.

Edhe një mësim me vlerë që parashtron Nursiu: “Njeriu që të arrijë përjetimin e të gjitha shkallëve të sunnetit të Pejgamberit (a.s.m.), duhet të bashkojë diturinë me devotshmërinë.” Pra morali i lartë arrihet edhe nga ndriçimi i mendjes me dituri, gjë që nuk mjafton, por duhet edhe zemra, edukata, bindja, devotshmëria. Dituria dhe devotshmëria duhet të jenë të lidhura ngushtë që ta drejtojnë njeriun në veprime të mira.

Ky shembull i dashurisë ndaj Profetit Muhammed, njëkja e rrugës së tij, dashuria ndaj veprës dhe jetës së tij, ndaj mësimeve të tija, është rruga drejt mësimeve të Zotit xh.sh., rruga drejt mëshirës dhe shpërblimit të All-llahut, drejt jetës së amshuar, drejt xhennetit. Në një ajet All-llahu bën të ditur se Profeti thotë: “Thuaj: në se e doni All-llahun, atëhere ejani pas meje që All-llahu t’ju dojë”.

Konkluzion: Qëllimi më i lartë i njeriut është që të fitojë dashurinë e All-llahut. Rruga për ta plotësuar këtë dëshirë, kalon nëpërmjet mbështetjes në sunnetin e Resulull-llahut.

Prandaj, o mik i nderuar, lexoje këtë libër ku do të gjesh arsyetime të holla filozofike e mësim të dobishme praktike. Në fund të fundit ke një shembull, ke një dritë që të udhëheq në mijëra kalime e udhëkryqe, e kjo është jeta dhe vepra e Profetit Fisnik, Hz. Muhammedit (s.a.v.s.).

Islam Dizdari

Shkodër, më 21.06.2001

FJALA E NËNTËMBËDHJETË

PROFETI MUHAMMED (A.S.)

وَمَا مَدَحْتُ مُحَمَّدًا بِمَقَالَتِي ۖ وَلَكِنْ مَدَحْتُ مَقَالَتِي بِمُحَمَّدٍ
(عليه الصلاة والسلام)

“Nuk e lavdërova unë Muhammedin me shkrimin tim, por është Bukuria e Muhammedit (a.s.m.), që ma hijeshon shkrimin”, ka thënë njëri.

Unë Saidi them: “Fjalët janë shumë të bukura, por ato i kanë zbukuruar edhe më shumë, cilësitë e Muhammedit (a.s.m.)”.

Shkëlqimin e jetës së Muhammedit (a.s.) do ta paraqesim në katërmëdhjetë pika.

Pika e parë: Tre argumente të mëdha janë që na njoftojnë Krijuesin tonë.

Njëri libri i madh i gjithësisë, i cili është i shkruar me shkronja të mëdha.

I dyti vula e profetëve, veçanërisht Hz. Muhammedi (a.s.m), i cili është edhe pasqyra e gjithësisë.

I treti është Kur'ani Famëlartë.

Tani së pari të njohim argumentin e dytë i cili flet dhe që është vula e profetëve, pra Hz. Muhammedi (a.s.m).

Shohim se për shkak të personalitetit të Tij shpirtëror, sipërfaqja e tokës është bërë një xhami, qyteti i Mekës një mihrab (vendi i imami) dhe qyteti i Medinës një minber (vendi ku mban ligjëratë vaizi).

Nga ky argument duket qartë se Profeti ynë (a.s.m). është Imami i të gjithë besimtarëve, gojtari i të gjithë njerëzve dhe Kryetari i Profetëve dhe njerëzve të shenjtë. Ai ka qenë kryetari i radhës për të përmendur All-llahun xh.sh., rrënjët e gjalla të të Cilit kanë qenë të gjithë profetët dhe evlijatë, që duke u mbështetur mrekullive, (qerameteve) të tyre, vërtetojnë Pejgamberin tonë (a.s.m).

Mendimet e tij së bashku me mrekullitë e veta, i kanë vërtetuar të gjithë njerezit e lartë. Këtë të vërtetë e kanë nënshkruar unanimisht. Ai ka thënë:

(1) لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

Në rrjedhën e së kaluarës dhe të së ardhmes, të gjithë njerezit e ndritur, që janë besimtarë dhe përmendin All-llahun xh.sh., në veshin e së ardhmes, me një gojë si një kor madhështor, përsërisin fjalën “La ilahe-il-lall-llah”, duke ia vërtetuar dhe pohuar këtë.

Tani fol po deshe për këtë argument të pamohueshëm, i cili është vërtetuar me nënshkrimin e mesazheve të zbritura dhe le të guxojë imagjinata e kujt të dojë ta mohojë po mundi.

Pika e dytë: Ky argument i ndritur vërteton dërgimin e Muhammedit (a.s.m.), me mendimin unik të njerëzve të ndritur, në të dy kohët; për të kaluarën dhe të ardhmen. Profetësia e tij vërtetohet edhe nga librat e zbritur si Teurati dhe Inxhili (Ungjilli), si dhe nga qindra shënime të zbuluara. Bile akoma pa lindur ende Hz. Muhammedi (a.s.m.), mijëra paralajmërime dhe gojdhëna të pleqëve, vazhdimisht, duke u mbështetur mbi bazën e paralajmërimeve të librave të zbritur, me anë të disa shenjave të fshehta kanë dhënë sihariqin (lajmin) e ardhjes së Tij.

Z. Husejin Xhisriu në librin e tij “Risaleti Hamidije”, nga studimi që u ka bërë librave të zbritur, përsëri përveç shenjave të hequra për Muhammedin a.sm. nga kundërshtarët, në 114 vende ka konstatuar paralajmërime për ardhjen e Hz. Muhammedit (a.s.). Në këto shënime sado që të përpiqesh nuk mund të gjesh asnjë lloj fallsifikimi.

Përpos kësaj edhe mijëra mrekulli të tjera e vërtetojnë mrekullinë e tij që me një të luajtur

të gishtit e ndau Hënën në dysh. Bile akoma pa ardhur me shumë shenja, është vërtetuar për ardhjen e Fisnikut Muhammed (a.s.). Në Personalitetin e Tij janë shfaqur cilësitë më të bukura të veprimeve të Tij. Në këto karakteristika hyn edhe besnikëria, pra mostradhëtimi i çështjes të cilën Ai mbron. Me besimin e Tij të Përsosur, me bindjen e Tij Absolute, gjithëmonë ka mundur ta argumentojë qëndrimin e Vet; devotshmërinë e jashtëzakonshme, adhurimin, seriozitetin dhe qëndrueshmërinë e paepur. Me këto cilësi, ashtu siç duket dielli gjatë ditës, ka mundur të tregojë se Ai është një njeri shumë i drejtë....

Pika e tretë: Nëse dëshirojmë le të kthehemi në shekullin e lumtur, në gadishullin arabik, duke e imagjinuar Atë vazhdimisht në krye të obligimeve të veta. Tani vëreje me vëmendje se Ai me veprat e bukura dhe me fytyrën fisnike, është një Person i Posaçëm. Ai mban në dorë një Libër të Mrekullueshëm. Gjuha e Tij nuk shpreh gjë tjetër veçse të drejtën për t'iu ligjëruar të gjithë bijve të Ademit, ndoshta të gjithë xhindëve, njerëzve dhe melekëve (engjëjve), mbase të gjithë të vetëdijshëmve. Ai ka marrë në dorë Kur'anin duke ligjëruar Mesazhin e Përjetshëm të All-llahut xh.sh.. Po sqaron arsyet dhe Sekretin e Çuditshëm, që është formuluar në këto tre pyetje, që janë të detyruar t'i përgjigjen të gjithë të vetëdijshmit, sepse ato pyetje kanë pushtuar mendjet e njerëzve: “Çfarë je? Nga vjen? Ku po shkon?” Pikërisht Ai u është përgjigjur dhe i ka sqaruar këto probleme me një përpikmëri të përsosur.....

Pika e katërt: Shiko me vëmendje si po e shpërndan Dritën e së Vërtetës me Fenë e Tij, të cilën s'mund ta mbulojë dot. Po të mos ishte kjo Dritë, atëhere kjo gjithësi do të duket sikur e ka mbuluar zia. Qeniet do të dukeshin të huaja për njëra tjetrën, ndoshta gati për të shpallur armiqësinë midis tyre. Qeniet e pashpirta do të konsideroheshin si kufoma të trishtuara dhe të çuditshme, kurse ato me shpirt do të dukeshin si jetime.

Tani shiko! Pasi Ai shpalli Fenë e Tij, gjithësia u mbulua me shkëlqim dhe ndërroi trajtë. Nga gjendja e zisë që e mbështillte më parë, u përfshi nga gazmendi dhe lumturia, sepse tani po përmendej Emri i Krijuesit të qenieve, me tërë ndriçimin e Dritës së Fesë së Tij. Kjo Dritë e Shenjtë vendosi paqen midis qenieve. Më parë mbizotëronin vrasjet dhe hasmëritë, kurse tani u lënë mënjanë grindjet dhe gjakderdhjet midis të huajve dhe kudo u shpërnda fryma e miqësisë dhe vëllazërimit. Ato kufoma të heshtura, tani morën një formë, ku secila u shndërrua si një nëpunës apo shërbëtor i bindur dhe i dëgjueshëm. Jetimët e përvuajtur u kthyen në njerëz gazmendë dhe të gjithë në një kor gjigand brohorisnin dhe në çdo çast shqiptonin Emrin e Krijuesit, i Cili u dha mundësinë, që nga gjendja e punës së rëndë, të shkojnë në atë të prehjes dhe rehatisë.

Pika e pestë: Këto lëvizje dhe shndërrime, që më parë dukeshin të pakuptimta dhe të thjeshta, nën Dritën e Fesë së Tij, u transformuan nga lojëra të rastësishme dhe të rëndomta, në Mesazhe të Edukatorit, si dhe në një pasqyrë të argumenteve, për ekzistencën e Emrave të Bukur të Krijuesit. E tërë Gjithësia merr formën e një Libri të Mrekullueshëm. Sikur të mos ekzistonte kjo Dritë, njeriu i hedhur në gjendjen e një kafshe të dobët, me një mendje të pazhvilluar, që e rrënon dhe e bën fatkeq, do të shkonte edhe më tej drejt mjerimit. Ardhja e fesë e lartësoi njeriun në rangun më të lartë ndaj të gjitha krijesave dhe e shndërroi në një mbret nazik dhe të zgjuar. Ai filloi të lutet për veten, si një krijesë e dobët, nazike dhe e varfër, duke u ngritur përmbi kafshët dhe

krijesat e tjera. Pra, a e kupton se po të mos ishte Drita e Fesë së Tij, gjithësia dhe njeriu do të zbriste në shkallën zero? Këtë të vërtetë të pashoqe mbi gjithësinë ka mundur ta sqarojë vetëm një person i Famshëm dhe Ai është Hz. Muhammedi (a.s.m.). Po të mos ishte sqaruar kjo e vërtetë edhe Gjithësia edhe njeriu do të ishin në një gendje, që më mirë të mos ekzistonin.

Pika e gjashtë: Shiko! Ai person i ndershëm, duke qenë Lajmëtari i Jetës së Kënaqësisë së Përtejshme, është edhe zbuluesi i Mëshirës së Paskajshme dhe i Bukurisë së Emrave të Edukatorit. Ai është zbuluesi dhe soditësi i thesareve hyjnore. Atë po ta shikosh nga ana e vetive, të duket si një shembull i përsosur i dashamirësisë dhe i mëshirës, që e ka shtuar respektin tek njerëzimi. Gjithashtu po ta vëzhgosh për nga zemërgjerësia, Ai shëmbëllen me një ylber që ndriçon Pemën e krijimit të gjithësisë. Po ta gjykosh nga ana e Pejgamberisë, Ai të duket si një argument i Drejtësisë dhe si Drita e vërtetë e diellit për udhërrëfyesin. Ai është si një mundësi shpëtimi.

Shiko, Drita e Fesë së Tij, si një mjet shpëtimi është përhapur nga lindja në perëndim, ku gjysma e botës dhe një e pesta e njerëzimit, nga kjo fe ka gjetur shpëtimin. Këtë dhuratë të çmuar e solli Ai.

Ç’do të bëhet me shejtanin dhe nefsin tonë, që Fjalën e Shenjtë:

(1) لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

e cila është thelbi i të gjitha çështjeve të atij personi, nuk e pranojmë me të gjitha shkallët e saj?

Pika e shtatë: Shiko! Në ishullin e gjerë, në mes të popujve ambiciozë, të pakulturuar, të egër dhe të pashkollë, në një kohë të shkurtër Ai mundi të heqë nga koka e tyre traditat e vjetra dhe të egra, duke ua zëvendësuar ato me moralin e pastër dhe karakterin e fortë. Duke vepruar kështu, Ai mundi që ata njerëz të egër dhe injorantë t’i kthejë në mësues dhe mjeshtra për të edukuar popujt e tjerë, që konsideroheshin të kulturuar.

Shiko, jo me tirani, por me bindje Ai i pushtoi mendjet, zemrat dhe shpirtërat, duke i ndërgjegjësuar që të bëhen me të vërtetë të qytetëruar me përkushtueshmërinë më të madhe. Me këto veprime, Ai u bë i dashuri i zemrave, mësuesi i mendjeve, eliminuesi i nefseve dhe Sulltani i shpirtëve.


Pika e tetë: E dimë mirë se edhe për një ves të vogël, siç është pirja e duhanit, edhe një sundimtari të madh i duhen shumë përpjekje për ta ndaluar.

Tani shiko! Profeti ynë, shumë tradita të forta dhe të vjetëruara të popujve të mëdhenj dhe ambiciozë, me pak mundim apo në një kohë fare të shkurtër, ka mundur t’i shkulë, duke mbjellur në vend të tyre cilësitë më të bukura. Ai është përpjekur që këto tradita tua ngulë

në mendje dhe në zemër, duke ua bërë të tyre dhe duke i shndërruar ata në besimtarë të devotshëm. Ja pra, këto vepra të vyera i ka bërë Ai. Tani, shekullin e lumtur dhe atë gadishullin arabik do t'i fusim në syrin e atyre që mohojnë Profetësinë e Tij. Le të ngrihen dhe le të shkojnë atje me qindra filozofë dhe le të punojnë njëqind vjet, përsëri një përqind të veprave të Profetit Fisnik, nuk do të mundën t'i realizojnë (megjithëse ai nuk ka ditur as të shkruajë e as të lexojë).

Pika e nëntë: E dimë mirë se një njeri i vogël e i thjeshtë, në një bashkësi të vogël, ku do të diskutojë dhe të mbrojë një çështje të debatueshme dhe fare të vogël, po hipi në podium të debatojë me armiqtë e tij, nuk do të mundet të mbrohet dot, pa u emocionuar. Përballë armiqve të tmerrshëm, ai nuk do të mundte të fliste gënjeshtër të turpshme, sepse do t'i lidhej fjala në grykë prej frikës.

Tani shiko! Profeti Fisnik, me një detyrë shumë herë më të madhe, me një obligim shumë herë më të madh dhe me një nder të lartë, pa ngurruar fare, përpara një bashkësie të madhe, përballë armiqve të shumtë dhe të mëdhenj, kur ka ardhur puna për të diskutuar për çështje të rëndësishme në podiumin madhështor, duke qenë nevojtar i sigurimit, me një qetësi shembullore, pa u tërhequr apo turpëruar, pa u dridhur dhe i qetë shpirtërisht, me një seriozitet të madh, ka lëshuar fjalë të mahnitshme. Këto fjalë i kanë tmerruar armiqtë, sepse kanë qenë të drejta, me një mesazh të shenjtë dhe të shprehura në formën më të lartë. Fjalët e Tij a ka mundësi të jenë tradhëti?... Asnjëherë, kurrë!

(1) 

Ja pra e drejta kurrë nuk të mashtron dhe i drejti nuk mashtrohet kurrë. Profetësia e të Drejtit është larg nga dredhia dhe tradhëtia. Në syrin e të drejtit imagjinata e askujt nuk guxon ta paraqesë veten ndryshe nga ç'është dhe të mashtrojë....

Pika e dhjetë: E shikon edhe vetë se duke treguar të vërtetën, duke i argumentuar mirë çështjet edhe ata që dyshojnë i tërheq për nga vetja, që ta kuptojnë se çështjet e Tij, po aq sa janë të vështira janë edhe të nevojshme.

E dini edhe vetë se më shumë se sa merak, njeriun asgjë tjetër nuk e nxit. Nëse ty dikush do të të kërkonte gjysmën e mallit, me konditë që të të japë lajm nga Jupiteri apo nga Hëna dhe të tregonte gjithçka për të ardhmen tënde, po qe se ti, do të kishe kureshtje të madhe, do ta jepje pa u tërhequr dhe hezituar. Pejgamberi ynë Fisnik jep lajmin e Sundimtarit të botërave, se Hëna në Atdheun e Tij është si një mizë dhe rruzulli ynë sillet rreth Diellit, që është një llambë ndriçuese në një nga mijëra botërat e Atij Sundimtari, ndërsa në Botën e Tij dielli është si një llambë e vogël e përbërë nga mijëra fenerë ndriçues. Ky Person i Ndershëm, prej të tilla botërash të çuditshme, po na jep lajme dhe ashtu për qarkullimin e cikleve, duke na treguar për shndërrimet, na lajmëron që edhe sikur mijëra botëra të kishin plasur si bombë, nuk do të kishte ndodhur një gjë kaq e çuditshme.

Shiko si po jep lajme në gjuhën e Tij (Zoti xh.sh.):

إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ ﴿١﴾ إِذَا السَّمَاءُ أَنْفَطَرَتْ ﴿٢﴾ أَلْقَارَعُ ﴿٣﴾

Me sure (kapitull) të tillë po lajmëron për një të ardhme dhe lumturi të vërtetë. Shndërrimet e zhvillimit që ndodhin në këtë botë, pranë lajmeve të Tija janë si një pikë uji, po t'i krahasosh me lumturinë e Përjetshme. Ai me seriozitet, jep lajmin e një jete të lumtur, ku përpara kënaqësive të përtëjshme, kënaqësitë e kësaj bote janë si një rrufe kalimtare në diellin e shndritshëm.

Pika e njëmbëdhjetë: Për të ndriçuar këto të fshehta të errëta të gjithësisë dhe për të ngritur këto perde të panjohura dhe të çuditshme, duhej vetëm një Profet Fisnik dhe i Mrekullueshëm, si Muhammedi (a.s.m.), që zotëronte një fuqi të jashtëzakonshme. Ai na tregon se çfarë kërkon prej nesh All-Ilahu i qiejve dhe i tokës, që rruzullin tokësor e ka mbushur me mirësi, për t'i gëzuar njerëzit këto të mira. Më parë duhet të mësojmë se me çfarë veprash ta gëzojmë Bamirësin tonë. Këto probleme po na i mëson shumë qartë duke i shoqëruar ato me argumente të sakta.

Tani për të dëgjuar këto fjalë dhe këtë Profet a.s.m., është e nevojshme për të vepruar sipas urdhërave të Tij.

Çfarë ka shumicave e njerëzve që janë bërë si të shurdhër, si të verbër dhe të shushatur, saqë edhe të drejtën nuk po mundin ta dallojnë? Pse nuk po i dëgjojnë, nuk po i shohin apo nuk i kuptojnë këto punë kaq të qarta?

Pika e dymbëdhjetë: Tani Pejgamberi Fisnik (a.s.), për ekzistencën e Krijuesit të gjithësisë është një argument i vërtetë dhe një dëshmi që flet qartë për Ringjalljen dhe Lumturinë e Përjetshme. Ai është një dëshmitar i Fortë, për të vërtetuar ekzistencën e Lumturisë së Përjetshme, si dhe për të treguar mënyrën për ta arritur atë. Lutja e tij është një arsye e krijimit të xhennetit, siç është theksuar në librin “Ringjallja”. Meqë ka lidhje me këtë temë përsëri po e përsërisim se i Dërguari Fisnik (a.s.m.), në Namazin e Madh dhe në Adhurimin e Lartë, lutet për Lumturinë e Përjetshme. Gjithashtu jo vetëm gadishulli, por e gjithë bota, kudo që janë myslimanët, luten së bashku dhe bashkohen me lutjen dhe adhurimin e Tij madhështor, sepse falja e tij është një përmbledhje e të gjitha adhurimeve të atyre që kanë pranuar fenë e tij. Hz. Muhammedi (a.s.m.) është përfaqësuesi i të gjithë profetëve. Në këtë namaz ai shpreh të gjitha adhurimet dhe respektin e tyre të thellë. Ky namaz i madh i tij është si një bashkim i të gjithë namazeve të bijve të Ademit, që nga ajo ditë, deri në ditën e kijametit. Të gjithë njerëzit e devotshëm dhe të ndershëm që ndjekin rrugën e Tij, kësaj lutjeje në një kor të madh po i thonë: “Amin!” (pranona o Zot). Shiko Pejgamberin tonë që lutet për nevojat e të gjithë njerëzve dhe për ata që janë në qiell, ndoshta për të gjitha qëniet, të cilat së bashku duke u pajtuar me lutjen e tij, po thonë: “Po, jepe o Zot atë që ai kërkon!” Kështu me këto fjalë, atë e shoqërojnë të gjitha qëniet, duke u lutur me një zë të ëmbël dhe të dashur, që shpreh

varfërinë, dobësinë, modestinë dhe dashamirësinë e tyre ndaj All-llahut xh.sh., duke kërkuar që lutja e tij të dëgjohej. Duke u lutur kështu, ata e bëjnë gjithësinë të lotojë.

O vëlla! Ta dish se vetë jeta e Pejgamberit Fisnik, tregon se ai lutet për një qëllim të madh; që jo vetëm të shpëtojë njeriun, por ndoshta të gjitha qeniet nga pusi i thellë, nga asgjëja, nga zhvlerësimi, nga padobishmëria dhe t'i ngrejë në pozitë më të larta, që të shkojnë në përjetësi dhe të fitojnë vlerat e duhura.

Shiko! Ai lutet me një zë të ëmbël dhe kërkon ndihmë duke u shpërndarë zëri i Tij në të gjithë qiejt dhe tek të gjitha qeniet, të cilat sëbashku, Lutjes së Tij i përgjigjen me këto fjalë të bukura: “Amin, All-llahumme Amin!” Nevojat e Tij ia kërkon edhe Dëgjuesit dhe Vëzhguesit të Plotmëshirshëm dhe të Ditur, sepse Ai këto nevoja të të gjallëve, sado të vogla, i sheh dhe i dëgjon dhe Mëshira e Tij e Madhe i pranon dhe i plotëson. Kjo ndodh edhe për arsyen se jo vetëm për faktin që këto kërkesa janë paraqitur me gojë, por ato shprehin edhe me gjendjen e tyre të vërtetë, në një mënyrë të qartë që tregon për një vetëdije të mrekullueshme. Duke dëgjuar këto lutje bëhet fare e qartë dhe e padyshimtë se çdo gjë është realizuar dhe është parë nga ana e Shikuesit dhe Fisnikut të Plotmëshirshëm si një vepër e rrallë.

Pika e trembëdhjetë: I Dërguari i Posaçëm me vete ka tërhequr të gjithë bijtë e Ademit dhe duke dalur në podium, është kthyer nga “Arshi i Madh” me duart e ngritura dhe ka bërë dua (është lutur). Profeti që është edhe lavdia e njerëzimit, po lutet me zërin e Tij që gjëmon në të gjitha kohërat dhe që e dëgjojnë të gjitha qeniet. Cila është kërkesa e Tij? Ai kërkon lumturinë e Përjetshme, Jetën e Paskajshme në parajsën e lumtur dhe të takohet me të Madhin Zot, All-llahun xh.sh.. Veç kësaj, ai kërkon të përballohet me të gjitha bukuritë e amshueshme dhe me madhështitë e funksioneve të të gjithë Emrave të Bukur (Esmā ul-Husna). Bile, Mëshira, Ndihma dhe Dituria e Kulluar e Drejtësisë Absolute, edhe po të mos kishte nevojitur krijimin e xhennetit, vetëm lutja e të Dërguarit mjafton për të krijuar parajsën, lumturinë e përjetshme, gjë shumë e rëndësishme, krijim që për All-llahun është i lehtë si krijimi i pranverës. Pra siç është pejgamberia e Tij një arsye dhe shkak për të sqaruar këtë vend të provës, po ashtu edhe lutja me Ibadetin e Tij, është një arsye e qartë, për krijimin e Jetës së Lumtur. Njerëzit e mençur të krahut të vërtetë ç’i ka shtyrë të thonë:

(1) لَيْسَ فِي الْإِمْكَانِ أَبْدَعُ مِمَّا كَانَ

Ky rregull i përsosur dhe i veçantë i natyrës është krijuar vetëm prej një Plotmëshiruesi. Vetëm Ai mund të krijojë këto arte dhe relike me një bukuri të pashoqe. A e vëren se Edukata e Tij nuk pajtohet me të shëmtuarën, smirën, pamëshirshmërinë dhe çrregullimin? Me sytë tanë po e shohim se dëshirat dhe kërkesat më të parëndësishme Ai po i pranon. Po si ka mundësi të mos pranojë lutjen e Ringjalljes të Lumturisë së Përjetshme, që është gjëja më e rëndësishme? A ka mundësi që Ai këto të mos i krijojë? Jo kjo nuk do të ndodhë kurrë! Bukuria e Tij e rrallë nuk mund të shëmtohet kurrë në këtë mënyrë.

O shok imagjinar! Kjo që ju thamë është e mjaftueshme, por le të kthehemi tani pak më mbrapa, sepse përndryshe edhe njëqind vjet tek ky gadishull po të qëndronim, përsëri veprimtarinë e çuditshme dhe detyrat e habitshme të Profetit, ne nuk mund t'i konceptonim dot. Tani duke u kthyer mbrapa, do të shohim se në secilin shekull me Dritën e Uruar të Diellit së Fesë së Tij, akoma më shumë lule kanë lulëzuar, siç janë Ebu Hanife, Shafii, Bejazidi Bistami, Shejhi Gejlani, Shejhi Nakshibendi, Imami Gazali, Imami Rabbani, si dhe miliona rubinë të tjerë ndriçues. Shpjegimet dhe thëniet e mia po i lëmë në udhën e tyre, për tjetër herë, si dhe mrekullitë e pasosura të tij, për t'i shprehur atij një përshëndetje:

عَلَى مَنْ أَنْزَلَ عَلَيْهِ الْفُرْقَانَ الْحَكِيمُ مِنَ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ مِنَ
 الْعَرْشِ الْعَظِيمِ ❁ سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ أَلْفِ صَلَاةٍ
 وَأَلْفِ سَلَامٍ بَعْدَ حَسَنَاتِ أُمَّتِهِ عَلَى مَنْ بَشَّرَ
 بِرِسَالَتِهِ التَّوْرَةَ وَالْإِنْجِيلَ وَالزَّبُورَ ❁ وَبَشَّرَ
 بِنُبُوتِهِ الْإِرْهَاصَاتِ وَهَوَانِ الْإِحْنِ وَأَوْلِيَاءِ
 الْإِنْسِ وَكَوَاهِنِ الْبَشَرِ ❁ وَأَنْشَقَّ بِإِشَارَتِهِ الْقَمَرُ
 سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ أَلْفِ صَلَاةٍ وَسَلَامٍ بَعْدَ أَنْفَاسٍ
 أَمَّنِهِ ❁ عَلَى مَنْ جَاءَتْ لِدَعْوَانِهِ الشَّجَرُ وَنَزَلَ سُرْعَةً
 بِدُعَائِهِ الْمَطَرُ وَأَظْلَمَتْهُ الْغَمَامَةُ مِنَ الْحَرِّ ❁ وَشَبَعَ
 مِنْ صَاعٍ مِنْ طَعَامِهِ مِائَتٌ مِنَ الْبَشَرِ وَنَبَعَ الْمَاءُ مِنْ بَيْنِ
 أَصَابِعِهِ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ كَالْكُوْثَرِ وَأَنْطَقَ اللَّهُ لَهُ الضَّبُّ وَ

الظُّبُوَ وَأُبْجَذَعُ وَالذِّرَاعُ وَالْجَمَلُ وَالْجَبَلُ وَالْمَجْدَرُ
 وَالْمُدَّرُ صَاحِبِ الْمِعْرَاجِ وَمَا زَاغَ الْبَصَرُ ﴿١٠٠﴾ سَيِّدِنَا
 وَشَفِيعِنَا مُحَمَّدٍ أَلْفُ أَلْفِ صَلَاةٍ وَسَلَامٍ بِعَدَدِ
 كُلِّ أَحْرُوفٍ فِي الْمُتَشَكِّلَةِ فِي الْكَلِمَاتِ الْمُتَمَثِّلَةِ
 بِإِذْنِ الرَّحْمَنِ فِي مَرَايَا تَمْوُجَاتِ الْهَوَاءِ عِنْدَ قِرَاءَةِ
 كُلِّ كَلِمَةٍ مِنَ الْقُرْآنِ مِنْ كُلِّ قَارِءٍ مِنْ
 أَوَّلِ النُّزُولِ إِلَى آخِرِ الزَّمَانِ ﴿١٠١﴾ وَاعْفُرْنَا
 وَارْحَمْنَا يَا إِلَهَنَا بِكُلِّ صَلَاةٍ مِنْهَا آمِينَ ﴿١٠٢﴾

Pika e katërmbëdhjetë: Thesari i Mrekullive dhe Mrekullia më e Madhe është zbritja e Kur'anit të Famshëm, që vërteton edhe Profetësinë e Muhammedit (a.s.m.), në atë mënyrë sa nuk lë vend për vërejtje të tjera. Mrekullitë e tij shpesh janë kundërshtuar nga shumë njerëz të paditur.

Krijuesin tonë na e njofton Kur'ani i Famshëm, i cili vërteton se Ai vetë është përkthyesi i gjithanshëm i Librit të gjithësisë. Ai është zbuluesi i Thesareve të mbuluara dhe i Emrave të Zotit xh.sh., që janë shpërndarë në të gjithë sipërfaqen e botës dhe tek secila qenie. Ai është çelësi i zbulimit të ndodhive që kanë mbetur në hije me kalimin e kohës, si dhe është thesari, Arka e Mesazheve dhe e Dhuratave Hyjnore të All-llahut xh.sh., të cilat qëndrojnë të fshehura në botëra të panjohura, nën perden e kësaj bote. Po ashtu Ai është edhe Dielli, Themeli dhe Gjeometria shpirtërore e Fesë Islame si dhe Harta e botërave të fshehta. Ai është Fjala e qartë e All-llahut xh.sh. dhe Pasqyra e funksioneve të Emrave të Bukur. Është një koment i padyshimtë, si dhe një argument i fortë i Tij, që shpreh vetëm të vërtetën. Duke vazhduar, Ai është edhe një përkthyes i Lartë, një Edukator i njerëzimit dhe Dituria e Kulluar e së vërtetës. Është një Udhërrëfyes dhe Shpëtimtar. Është një Libër shkence dhe ligjesh. Mbi të gjitha, Ai është një Libër lutjesh dhe adhurimesh. Ky Libër ta drejton rrugën nga e mira dhe të shmang nga e keqja. Është gjithashtu edhe Libër i përmendjes së All-llahut xh.sh. dhe i njoftimit të Tij.

Pra Kur'ani është në gjendje t'u përgjigjet të gjitha nevojave shpirtërore, për secilën kategori njohurish dhe secilin karakter në veçanti, siç janë evlijatë dhe njerëzit e rrugës së drejtë, të cilëve u është vërtetuar devotshmëria.

Ai u përgjigjet të gjitha atyre kërkesave, të cilat kanë në bazën e tyre fenë islame, sepse dihet që Kur'ani është një literaturë e amshueshme.

Përsëritja e Kur'anit, veprim që konsiderohet i gabuar, pikërisht ajo, bën të shkëlqejë Mrekullia e Tij. Meqënëse është Libri i Përmendjes së Zotit xh.sh., i lutjes dhe i ftesës për në fenë islame, këto përsëritje mirëpritën dhe konsiderohen si të domosdoshme, për ta shprehur atë sa më bukur. Si shkak gabimi që paraqitet përsëritja e Kur'anit, ajo është për të forcuar dritën e saj. Përsëritja e duasë është e rëndësishme kur përsëritet, duke e përforcuar rezultatin, i cili tregon qartë forcën ushqyese të Kur'anit. Për këtë arsye duke i përsëritur vazhdimisht forcohet rëndësia e saj, sepse çdokush nuk ka aftësi ta lexojë të gjithë Kur'anin, kurse një kapitull të Tij edhe mund ta lexojë. Kështu kapitujt e gjatë të Kur'anit, që përmbajnë qëllimet më të rëndësishme, janë përmbledhur në kapituj të vegjël, ku secili është quajtur një Kur'an i vogël. Kjo është bërë për arsye që askush të mos vuajë, për t'i përsëritur këto ajete të sureve më të rëndësishme, që janë edhe temat kryesore të Kur'anit. Këto tema duhet të përsëriten, për arsye se përmbajnë Njësimin e All-llahut, Ringjalljen, që nganjëherë bën fjalë për Musain (a.s.), apo edhe për nevojat e shumëllojshme materiale dhe shpirtërore të njeriut. Si shembull mund të sjellim se medoemos çdo çast, trupi i njeriut ka nevojë për ajër që të jetojë, po kështu edhe shpirti i tij vazhdimisht ka nevojë të thotë: "O Zot, Ti je Ai që na kursen çdo minutë". Kurse disa fjalë të amshuara si: "Bismil-lahir-rrahmanirr-rahim", është e nevojshme t'i thotë çdo orë. Pambarimisht shembujt vazhdojnë njëri pas tjetrit. Domethënë përsëritja e ajeteve ka lidhje me përsëritjen e nevojave, ndërsa nevoja vetë, të detyron dhe të nxit, që më me zell të kërkosh ndihmë tek All-llahu xh.sh.. Duhet ta dish se Kur'ani është Baza, Themeli dhe Kushtetuta e muslimanëve, që e përjetojnë Atë. Meqënëse Kur'ani është një Libër që iu përgjigjet të gjitha nevojave dhe kategorive të njerëzve, klasave të ndryshme dhe karaktereve të veçanta, për shekuj me radhë Ai e ka sundimin dhe do të vazhdojë deri në Kijamet. Përsëritja e vazhdueshme forcon edhe më shumë bindjen tek besimtari dhe e bën atë të qëndrueshëm.

Secili duhet ta dijë se Kur'ani nuk është një Libër i thjeshtë. Mesazhet e Tija janë aq të larta dhe të holla, saqë ato përnjëherë s'mund të kuptohen për të hyrë në zemrat e njerëzve që të bëhen të qëndrueshme. Doemos nevojitet që vazhdimisht të përsëriten, sepse tek kjo përsëritje besimtari ka çfarë të mësojë. Sa herë që t'i lexosh, aq herë të tjera mëson prej Tij, sepse çdo ajet shpreh dobi të lloj-llojshme dhe ka shumë domethënie. Pra Ai është një Libër me shumë anë, që u përgjigjet njerëzve me karakter të veçantë, që kanë jetuar në të gjithë shekujt.

Kur'ani përveç që është një Libër që me ajetet e tij shpreh shumë qëllime dhe domethënie, Ai ka edhe një Shkëlqim të Mrekullisë së Tij. Ai duke na mësuar shkencat e natyrës dhe ato materiale, pa u thelluar i shkon përciptazi, por me argumente të forta, na

bind se është mrekulli dhe nuk është ashtu siç pretendojnë mosbesimtarët. Nuk është gabim përsëritja, sepse nevoja e kërkon atë.

Ti thua pse nuk jep njohuri për shkencat e fizikës dhe filozofisë, siç kanë bërë shkencëtarët e sotëm. Disa çështje Ai shkurtimisht i ka shënuar dhe me disa të tjera ka përkëdhelur mendimet e përgjithshme, duke na i sqaruar. Ai tregimin e ka vazhduar në një formë të tillë që të mos shqetësojë shumicën e njerëzimit dhe mendimet e njerëzve të thjeshtë të mos i turbullojë dhe t'i lodhë.

Duke t'u përgjigjur ty o i panjohur që po më pyet, po i pate lexuar tregimet e mia të mëparshme, ndoshta e ke kuptuar se Kur'ani Famllartë, duke treguar për gjithësinë, bën fjalë për Krijuesin e Tij. Pra për të njohur Mjeshtrinë e Tij dhe jo siç mendojnë filozofët, të cilët e kanë humbur rrugën e vërtetë. Kur'ani ka për qëllim të njoftojë funksionet e Emrave të Bukur të All-llahut xh.sh., për çfarë i ka krijuar dhe se çfarë domethënie ka gjithësia. Këtë studim e bëjnë edhe filozofët, kur marrin njohuri për shekujt e mëparshëm, por Kur'ani në shekullin që ka zbritur, po të jepte një informatë mbi teknikën e sotme, kjo do të ishte një largim nga feja dhe kundër Mëshirës së All-llahut xh.sh.. Kur'ani për të vërtetuar ekzistencën e Krijuesit të Botës, paraqet si dëshmi gjithësinë. Me tregimet e Tij duke sqaruar pjesë nga Gjithësia. Ai i vë përpara vetes shkencëtarët, kur thotë se me të Dërguarit e Tij ka vizatuar skajet e përparimeve të llojeve të ndryshme të shkencave. "Ejani t'iu shoh nëse do t'ia arrini!" Kur'ani kur ka dhënë dituri për natyrën, ka pasur parasysh që këto të jenë të kuptueshme dhe jo enigmë për njerëzit e thjeshtë, sepse Ai është një udhërrëfyes i përgjithshëm dhe nuk përjashton askënd nga Mëshira e fesë. Kjo është edhe arsyeja që çështjet e rëndësishme t'i koncentrojë dhe t'i përmbledhë, duke u shprehur shkurt dhe prerë, pa stërhollime, që vetë mendja t'i përpunojë qartë fenomenet dhe të mos i përziejë me demagogjinë.

Për shembull duke folur për diellin thotë: "Është një llambë që sillet rreth e rrotull"; por për cilësitë e diellit nuk flet, ndoshta ngaqë ai është zemreku i rregullimit të planetëve dhe qendra e rregullsisë edhe pse vetë rregullsia është pasqyrë e Diturive të All-llahut xh.sh.. Këto janë edhe temat e Tij kryesore.

Kur'ani i Famshëm thotë:

(1) الشَّمْسُ تَجْرِي

me rrotullimin e tij të rregullt dhe të kalkuluar nga një Mjeshër Madhështor, duke u kulluar; vera, dimri, dita dhe nata. Askush nuk mund ta tjetërsojë dhe ndryshojë atë.

Në një ajet tjetër thuhet:

(2) **وَجَعَلَ الشَّمْسُ سِرَاجًا**

pra duke e bërë të ditur se bota është në formën e një pallati, ku brenda saj qëndrojnë të gjitha gjërat dhe hijeshitë, si dhe ushqimet e nevojshme, që janë përgatitur për njerëzit dhe për qeniet e tjera të gjalla. Dielli në atë pallat shërben si një mjet ndriçimi. Në këtë paragraf tregohet Mëshira e Madhështisë së Tij.

Shiko çfarë thotë filozofia fjalamane: “Dielli është një trup i madh i zjarrtë dhe i lëngshëm. Ai i tërheq të gjitha planetet rreth vetes, duke i sjellur rrotull tij”. Me këtë thënie të tmerrshme shpirti i njeriut turbullohet dhe me këtë tregim, njeriu nuk e përfytyron dot veten, përveç se në një botë të tmerrshme dhe të trishtuar. Ai e kupton se ana e dukshme e filozofisë është e ilustruar, por brenda saj paraqiten kotësitë dhe zbrazëtia. Njeriu nuk duhet të mashtohet nga shkëlqimi i rremë i filozofisë, por duhet ta përmbledhim respektin ndaj Kur’anit.

**اللَّهُمَّ اجْعَلِ الْقُرْآنَ شِفَاءً لَنَا وَلِكَاتِبِهِ وَأَمْثَالِهِ
مِنْ كُلِّ دَاءٍ وَمُؤْنِسًا لَنَا وَلَهُمْ فِي حَيَاتِنَا وَبَعْدَ مَوْتِنَا
وَفِي الدُّنْيَا قَرِينًا وَفِي الْقَبْرِ مُؤْنِسًا وَفِي الْقِيَمَةِ
شَفِيعًا وَعَلَى الصِّرَاطِ نُورًا وَمِنَ النَّارِ سِتْرًا وَجِجَابًا
وَفِي الْجَنَّةِ رَفِيقًا وَإِلَى الْخَيْرَاتِ كُفَاهًا دَلِيلًا وَإِمَامًا**

بِفَضْلِكَ وَجُودِكَ وَكَرَمِكَ وَرَحْمَتِكَ يَا أَكْرَمَ
 الْأَكْرَمِينَ وَيَا أَرْحَمَ الرَّاحِمِينَ ﴿١﴾ اللَّهُمَّ صَلِّ
 وَسَلِّمْ عَلَى مَنْ أَنْزَلَ عَلَيْهِ الْفُرْقَانَ الْحَكِيمَ وَعَلَى آلِهِ وَصَحْبِهِ
 أَجْمَعِينَ آمِينَ آمِينَ (1)

Vërejtje: Nëse do që të gësh një Arkë të Mrekullive, paraqitu tek “Rrezja e Katërbëdhjetë”. Ajo është pjesë e Risaleve në arabisht. Pikërisht tek “Pika e Gjashtë” e burimit të katërt, janë sqaruar dhe treguar “Pesëmbëdhjetë Mrekulli” nga të “Dyzet Mrekullitë” e Kur’anit.

SHKËLQIMI I NJËMBËDHJETË

“Mirkatussunneh ue tirjaki marazi bid’a”, që duhet kuptuar: “Shkallët për të përjetuar synnetin e Hz. Muhammedit (a.s.m.) dhe ilaçi i efektshëm për të mjekuar traditat që nuk pajtohen me jetën e Muhammedit (a.s.m.).”

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
 لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِنْ أَنْفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ
 مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ بِالْمُؤْمِنِينَ رَؤُوفٌ رَحِيمٌ (1)

Pozita e parë e këtij ajeti është: “Minhaxhussunneh, Rruga e Pejgamberit (a.s.m.)”.

Pozita e dytë është: “Mirkatussuneh”, që do të thotë: “Shkallët e synnetit të Pejgamberit (a.s.m.), që e ngrej në lartësinë e duhur”.

فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ عَلَيْهِ
 تَوَكَّلْتُ وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ ﴿١٧٧﴾
 قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ

Prej shkëlqimeve të shumta të këtyre dy Ajeteve të Mëdha, shkurtimisht do të shqyrtojmë vetëm të njëmbëdhjetin, në disa pika.

Pika e parë: Pejgamberi ynë, i Dërguari Fisnik, ka thënë:

مَنْ تَمَسَّكَ بِسُنَّتِي عِنْدَ فِسَادِ أُمَّتِي فَلَهُ أَجْرُ مِائَةِ شَهِيدٍ ﴿١٧٨﴾

Shiko se sa e rëndësishme është të mbështetesh në “synnetin e Resulull-llahut” (në rrugën e të Dërguarit tonë) a.s.m.. Veçanërisht kjo bëhet edhe më e rëndësishme kur shumica e njerëzve e braktisin rrugën e All-llahut xh.sh. dhe kur mizoria rritet. Në këtë moment të përjetosh një cilësi sado të vogël të Pejgamberit a.s.m., është një devotshmëri e madhe, e cila tregon një besim të fortë.

Ky veprim të sjell ndër mend Profetin (a.s.m.), në kohën kur drejtëpërsëdrejti merr si bazë përjetimin e vet, synnetin (rrugën e tij) dhe domosdoshmërisht, të kujton dhe të kthen tek prania e All-llahut xh.sh..

Kur të thuash dhe të bësh siç ka thënë Pejgamberi, atëhere ato punë të vogla dhe të thjeshta, që në dukje janë punë të zakonshme si ngrënia, pirja, shtrirja; do të kthehen në punë të mira të adhurimit, që përfitojnë sevape. Kjo ndodh për arsye se duke bërë këto punë të zakonshme, ti e ke kujtuar dhe je mbështetur tek Ai, pra tek i Dërguari (a.s.m.). Me këto veprime ke menduar se kjo është një sjellje e Ligjit të All-llahut xh.sh.. Kjo do të të kujtojë se po sjell ndër mend një gjë sado të vogël të Atij, që është Ligji i Tij, apo direkt vetë Zotin xh.sh., formuluesin e këtij Ligji. Në këtë çast zemra të kthehet nga Ai dhe me këtë veprim ke bërë një Ibadet, që të afron për nga prania e All-llahut xh.sh.. Sekretin e kësaj të vërtete është se kush i është mbështetur synnetit dhe ia ka bërë zakon vetes,

atëhere veprimet e tij të zakonshme i shndërron në adhurim (ibadet), kështu të gjithë jetën e vet, ky njeri e mbush me mirësi (sevape).


Pika e dytë: Imami Rabbani Ahmedi Farukiu (k.s.) ka thënë: “Unë kur vizitoja botën e shpirtërove, gjatë rrugës sime vura re se në mes të evlijave më të shndritshëm, më të madhërishtë, më të bukur dhe më të sigurtë, ishin ata që kishin bërë si qëllim të jetës së tyre përjetimin e synnetit të Pejgamberit (a.s.m.). Përderisa vumë re që evlijatë e shtresave të thjeshta, që ndiqnin Rrugën e Profetit (a.s.m.), ishin më të ndritur se sa disa të tjerë të shtresave të larta të tarikatave, duket se mënyra më e sigurtë me anë të së cilës mund t’i afrohem All-llahut xh.sh., është marrja për bazë, përjetimin e synnetit të Resulull-llahut (a.s.m.).

Po, përtëritësi i mijëvjeçarit të dytë (1) ka të drejtë për këtë, se e vërteta është në këtë drejtim dhe është e vërtetë se kush merr për bazë përjetimin e synnetit, ai ka hyrë nën hijen e pranisë së All-llahut xh.sh. dhe përfiton pozitën e të dashurve të vërtetë.

Pika e tretë: Pikërisht unë Saidi i varfër, në çastin kur u shkëputa nga Saidi i Moçëm, kur ende ndodhesha në mes të një stuhie të tmerrshme shpirtërore; me kryelartësinë e nefsit që më kishte gllabëruar, nuk e kisha gjetur akoma rrugën e vërtetë, por me mendje dhe zemër, luftoja dhe e kërkoja vazhdimisht këtë rrugë. Në ata momente nganjëherë ngrihesha shumë lart dhe një herë tjetër zhytesha në humnerë, në thellësira të tmerrshme. Pikërisht kur isha në këtë përshtjellim, e pashë se çështjet e synnetit të Pejgamberit a.s.m., bile me disa përpjekje të vogla, duhet t’i ndiqja, sepse ishin si busulla të drejtimit së anijes. Këtë shans, në mënyrë të njëjtë ma siguronte vetëm synneti i Resulull-llahut (a.s.m.), midis mijëra rrugëve, duke m’i shndritur rrugët e errëta, sikur të shtypja butonin e një llambe të madhe elektrike. Në këtë brengë shpirtërore, kur e shihja veten nën shtypjen e peshave të rënda për problemet që kisha, sapo zbatoja synnetin e Pejgamberit (a.s.m.), menjëherë më bëhej sikur barra ime më shkarkohej plotësisht dhe lehtësohesha. Bile në këtë mënyrë shpëtoja edhe nga dyshimet dhe veset. Pa u menduar kjo apo ajo rrugë është e drejtë apo jo, është e dobishme apo jo, me shkurtpamësinë time, me dobësinë dhe shtrëngimet që kisha, midis rrugëve të panumërta, të cilave nuk u dihej përfundimi, duke u mbështetur tek synneti i Pejgamberit a.s.m. gjeja qetësi.

Çuditërisht shtrëngimet më largoheshin, rrugët më ndriçoheshin dhe më krijohej bindja se po lëvizja nëpër një rrugë të mbarë dhe të sigurtë. Kështu edhe një herë po e vërtetoja gjykimin e Imam Rabbaniut.

Pika e katërt: Në kohën që po mendoja vdekjen dhe po vëreja me këmbëngulje fjalën e padyshimtë që thotë:

(1) 

nga hidhërimi që po ndahesha prej të gjitha qenieve, tek të cilat pashë vulën e përkohshmërisë, m’u duk vetja si një kufomë që qëndronte në majën e tre kufomave të

tjera.

E para: M'u duk vetja si një pllakë varri, sepse tërësia e të gjitha qenieve të gjalla, është si një kufomë shpirtërore, që ka lidhje me jetën time, që duket sikur ka hyrë në varrin e madh të së ardhmes.

E dyta: Duke krahasuar veten midis varreve të kësaj bote dhe varrit të madh të së kaluarës, më dukej sikur midis tyre isha si një pikë, që së shpejti do të zhdukej, apo si një milingonë që vdes shumë shpejt.

E treta: Në kohën e kijametit, ngaqë vdekja totale është e pashmangshme, ajo në syrin tim u shfaq sikur ka ekzistuar edhe në kohën e vdekjes së kufomës së madhe dhe i habitur e i trishtuar i solla sytë drejt së ardhmes. Aty padyshim vdekja ime do të ekzistojë. Besova se ajo është bërë me sekretin e këtij ajeti:

(1) فَإِنْ تَوَلَّوْا

Me vdekjen time ma kthejnë shpinën të gjitha qeniet dhe dashamirët. Duket sikur ato më braktisën vetë. Kur pashë në drejtim të së ardhmes ajo m'u duk në formën e një oqeani në të cilin medoemos do ta dërgonte shpirti im atje përjetësisht. Tani duke qenë në këtë gjendje të hallakatur, më erdhi një shpresë nga besimi dhe Kur'ani, që m'u shfaq nga kuptimi i këtij ajeti të famshëm që thotë:

فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ عَلَيْهِ
تَوَكَّلْتُ وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ (1)

Ky ajet m'u bë si një anije e sigurtë. Shpirti im hyri dhe u njësuva me këtë ajet me një besim të plotë. Atëhere e kuptova se përveç domethënies së qartë të këtij ajeti, kuptimi i tij më dha ngushëllim dhe u qetësua shumë shpejt. Pra kuptimi i qartë i këtij ajeti, të Dërguarit Fisnik i thotë: “Nëse ato që kanë humbur rrugën të largohen dhe të kthejnë shpinën, për të detyruar ty që t'i largohesh rrugës tënde dhe të braktisësh Ligjet e All-llahut, mos u merakos, por thuaju atyre: “Unë mbështetem tek All-llahu xh.sh.. Ai më mjafton dhe në vendin tuaj, Ai më sjell të tjerë që të më dëgjojnë. Sundimi i Tij përfshin të gjithë tërësinë dhe asnjë rebel nuk mund të arratiset nga kufijt e Tij. Edhe ata që kërkojnë mbështetje nuk ngelin pa ndihmë”. Kështu me kuptimin e dytë shpirtëror, Ai i thotë prijësve: “O njeri, i cili je kryetar dhe udhërrëfyes i krijesave, në qoftë se ty të braktisin të gjitha qeniet gjatë rrugës ku i udhëzon në rrugë të drejtë, në qoftë se të gjallët prej teje largohen për të vrapuar drejt vdekjes, në qoftë se njerëzit të kthejnë shpinën dhe hyjnë në varr, në qoftë se njerëzit e pakujdesshëm dhe të rrugës së gabuar nuk të dëgjojnë dhe vrapojnë drejt errësirës dhe asgjësë, mos u shqetëso, por atyreve thuaju: “All-llahu

mua më mjafton! Meqënëse Ai është me mua, çdo gjë ekziston për mua dhe përmbi çdo gjë jam i bindur se ata që po ikin, nuk po shkojnë drejt asgjësë, por në një Atdhe tjetër, sepse Ai është Zot i Arshit të Madh dhe në vend të atyre që nuk më dëgjojnë, dërgon ushtarë të tjerë nga armata e Tij e Madhe. Pra duhet ta dimë se ata që hyjnë në varr nuk kanë humbur, por janë transferuar në botëra të tjera dhe vendin e tyre All-llahu xh.sh. e zëvendëson me të tjerë. Përkundër atyre që e kanë vendin në errësirë, nga armata e Vet, All-llahu xh.sh. sjell shumë të tjerë, që janë të nënshtruar dhe ndjekin Rrugën e Tij të Gjerë.”

Meqë e vërteta është vetëm kjo: Përkundër dashamirësisë së të gjitha qenieve Ai më mjafton. Nga njëra anë le të qëndrojnë të gjitha miqësitë e qenieve, kurse në anën tjetër vetëm një Shkëlqim i Mëshirës së Tij i përshkon tej e tej!....

Pasi shpjeguam kuptimin e këtyre shënimeve, tani e sheh qartë se si u tjetërsua gjendja e atyre tre kufomave të tmerrshme.

Domethënë: Të gjitha qeniet, duhet t’i kuptosh dhe pranosh, se ato janë nën sundimin e një Dijetari të Kulluar, të Mëshiruesit dhe të Sundimtarit Absolut, prandaj nuk duhet të çuditesh kur udhëtojnë apo lëvizin dhe të detyruara shkojnë e vijnë; disa duke u çliruar nga detyrimet dhe të tjerat veshin këmishën e obligimeve. Kurse në këtë gjithësi, gjithçka duket sikurse shkon e vjen sa andej këndeje.

Pika e pestë: Ajeti thotë:

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ

Ajeti i All-llahut xh.sh. tregon se mbështetja tek syneti i Resulull-llahut (a.s.m.), sa është e rëndësishme, po aq është edhe e nevojshme, sepse ai sqaron çdo fenomen me një saktësi të plotë.

Pra në veçanti ky ajet i famshëm, në vetvete është një analogji e fortë, krahasim i logjikës. E tillë si në analogjinë e logjikës kur thuhet: “Nëse ka dalur dielli, atëhere dihet plotësisht se do të ketë ditë”. Për përfundimin pozitiv thuhet dielli ka dalur, duke e nënkuptuar se rrjedhimi i kësaj të vërtete është dita. Për të pranuar të kundërtën, d.m.th. gjendjen negative, thuhet se nata nuk ka përfunduar, kur dihet që dielli nuk ka dalur. Këto dy përfundime janë dhënë edhe me logjikën e shkencave konkrete. Identikisht edhe ky ajet i All-llahut xh.sh. do të thotë se: Nëse e doni All-llahun, duhet të mbështeteni tek profeti i Tij (a.s.m.), por nëse nuk mbështeteni tek profeti i All-llahut xh.sh., përfundimi është i qartë, pra nuk e doni All-llahun xh.sh.. Po që se e doni, atëhere mbështetuni dhe nderoni Profetin Fisnik (a.s.m.). Kush e beson All-llahun xh.sh. do t’i bindet Profetit (a.s.) tërësisht. Në mes të rrugëve së bindshmërisë që të çon tek All-llahu xh.sh., më e pranueshmja, më e drejta dhe më e shkurtëra, pa dyshim është rruga e të Dashurit të All-llahut xh.sh., që na e ka treguar për ta pasuar.

Pra All-llahu i Bukur, me Bujarinë e Tij, me mirësitë e ndryshme, e ka shtruar gjithësinë dhe nga të gjitha qeniet e vetëdijshme kërkon një përgjigje dhe një falenderim. Ky Fisnik Madhështor, që e ka hijeshuar këtë gjithësi me këto Arte të Bukura dhe të mrekullueshme, pa dyshim se prej qenieve të vetëdijshme do të zgjedhë një të cilën të flasë dhe që të bëhet përhapësi i Mesazheve të Tij në popull dhe të jetë një Udhërrëfyes dhe Prijës. Meqenëse kjo përsosmëri e gjithësisë është bërë si një pasqyrë ku reflektohet e gjithë Mjeshtëria e Vet, patjetër që do t'i duhej një mjet për ta treguar Bukurinë dhe Përsosmërinë e Mjeshtërisë së Tij, pra patjetër bartësi i këtyre vlerave duhet të ishte një Person i Ndershëm, që të kishte dhënë prova të përkushtueshme dhe njëkohësisht modelin e Adhurimit të shohin tek Ai, të ishte shembullor për të tjerët dhe t'i edukonte ata me moralin e tij të lartë. Gjithashtu t'i mësonte deri sa ata të merrnin nga cilësitë e tij të përkryera.

Shkurt: Dashuria për All-llahun xh.sh. e bën të nevojshme mbështetjen tek synneti i Pejgamberit (a.s.m.).

Vaj hallit atij që nuk i përkushton rëndësi synnetit të Pejgamberit, por shkon pas “bid’ateve” (ligjeve që nuk pajtohen me fenë).

Pika e gjashtë: Pejgamberi ynë (a.s.) ka thënë:

(1) كُلُّ بِدْعَةٍ ضَلَالَةٌ وَكُلُّ ضَلَالَةٍ فِي النَّارِ

Kurse ajeti thotë:

(2) الْيَوْمَ اكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ

Ligji i All-llahut, sheriati, ka gjetur përsosmërinë. Në këtë mënyrë me shpikje të reja të mos e pëlqesh atë dhe të thuash se kjo nuk është e mjaftueshme, duke u munduar të gjesh rrugë të tjera, kjo do të thotë se e ke hedhur veten në errësirë apo në zjarr.

“Sunneti senijje”. Rruga e Pejgamberit ndahet në disa shkallë; njëra prej tyre quhet “vaxhib”. Për të është folur gjerësisht në “Librat e Fesë”, sepse këto janë çështjet themelore të fesë dhe nuk tjetërsohen kurrë.

Pjesa tjetër është “neuafil”, adhurim dhe devotshmëri përveç atyre që ka urdhëruar Zoti xh.sh.. Vetë kjo pjesë ndahet në dy nënpjesë:

E para lidhet me adhurimin, të njëjtë me ibadetin e synneteve të Pejgamberit (a.s.m.). Kjo është treguar edhe në librat e drejtësisë së fesë Islame. T'i shndërrosh ato është bid’at (ligj që s’pajtohet me fenë).

E dyta është “adab” (sjellje morale). Edhe për këtë është folur shumë në librat që flasin për biografinë e Pejgamberit (a.s.m.). T’iu dalësh kundra këtyre, është bid’at. Ndaj qëndrimin të Pejgamberit tonë (a.s.m.) ky është një kundërshtim, që do të thotë se: “Unë e refuzoj dhe nuk dua të kem dobi prej asaj drite dhe prej këtij morali të vërtetë”. Kjo është sqaruar në kushtet e trajtimit të Pejgamberit (a.s.m.) dhe duhet t’u mbështetesh principeve të Tij në lëvizje, si p.sh.: si ka ngrënë, si ka pirë, si ka folur, si ka fjetur etj.. Të gjitha këto quhen adabe, morali i Resulull-llahut (a.s.m.). Kush mbështetet në këto trajtime të Tij ai zakonet e veta i ka shndërruar në adhurim dhe prej këtij morali mbushet shpirtërisht. Të mbështetesh dhe të veprosh duke marrë shembull nga ai, qoftë edhe në një sjellje të vogël, ajo ta përkujton Atë, duke të shndritur shpirtin. Brenda synneteve të Pejgamberit (a.s.m.), më të rëndësishmet janë shenjat e fesë Islame. Ato janë juridikë dhe në to ka “hak” i gjithë populli dhe ky rit quhet adhurim popullor, si p.sh. edhe pse natë e ka krijuar një person, siç është thirja e Ezanit Muhammedi, prej tij ka dobi i gjithë populli dhe nga braktisja e Tij ai mban përgjegjësi. Në këto synnete s’mund të hyjë hipokrizia dhe kjo është një shenjë njoftimi, megjithëse për këtë nuk ka urdhëruar Zoti xh.sh.. Kjo ka një rëndësi më të madhe se sa farzet individuale.

Pika e shtatë: Synneti i Pejgamberit është një moral, një sjellje dhe një arsye e bukur për t’u larguar nga gjërat e mëkatshme. Nuk ka asnjë çështje të vogël të Tij, që të mos ketë një Dritë apo moral të pastër. I Dërguari Fisnik ka thënë:

(1) **أَدَبِي رَبِّي فَأَحْسَنَ نَادِي**

Kush ka lexuar jetën e Tij dhe kush ka studiuar synnetin e Tij, me të vërtetë e ka kuptuar se të gjithë Moralit e Lartë, All-llahu xh.sh. e ka përmbledhur në të Dashurin e Tij. Kush braktis synnetin e Tij, ai patjetër ka humbur moralin dhe do të përballet me këtë fjalë:

(1) **بِي آدَابٍ مَحْرُومٍ بَأْسُهُ أَزْلُفٍ رَبِّ**

duke rënë në një gropë të thellë imoraliteti dhe paturpësie.

Shtrohet pyetja: Meqenëse që nga gjërat e vogla dhe deri tek ato më të mëdhatë, All-llahu xh.sh. të vëzhgon, atëherë si mund të fshehësh përpara Dijetarit të fshehtësirave sjelljet e turpshme? Kjo gjë nuk mund të realizohet, ne vendet e turpshme nuk mund ti mbulojm ndaj All-llahu xh.sh. sepse ndaj Tij nuk mund të mbulojm sjelljet të turpshme, Ai i sheh sekretet më të fshehta. Ai shikon çdo gjë që ndodh midis krijesave të Tij.

Përgjigjja e parë: Më parë duhet ta dimë se All-llahu xh.sh., ashtu siç dëshiron të ekspozojë Artet e Bukura, po ashtu dëshiron edhe të mbulojë nën perde vendet dhe sjelljet e turpshme dhe të fëlliqura, për t’u tërhequr vëmendjen njerëzve, që të vlerësojnë

nimetet, mirësitë, si dhe anët e bukura të krijesave. Robëve të dashur dhe qenieve të vetëdijshme i këshillon të largohen nga e keqja dhe të mbulojnë vendet e turpshme, sepse kjo bie në kundërshtim me Emrat e Bukur të All-llahut xh.sh.; i Bukur, i Butë dhe i Urtë. Tani dhuntitë e bukura të Pejgamberit a.s.m. na mësojnë të jetojmë brenda kufijve të urdhërave të Mjeshtrit Madhështor dhe ato shprehin dhe shfaqin moralin më të bukur, tek synnetet e Pejgamberit.

Përgjigjja e dytë: Shpesh mjeku duke u nisur nga pikëpamja e vet e mjekimit, mund t'i vështrojë pjesët e turpshme të pacientëve. Të detyruar nga nevoja, atij i tregohet çdo e fshehtë dhe nuk mund të thuhet se, “nuk bën se është turp” dhe kjo nga që është e nevojshme, për vetë mënyrën e mjekimit. Mjeku, po ta gjykojmë nga pozicioni i një burri, apo e një këshilluesi, apo një hoxhë me detyrën e hoxhalletkut, nuk mund t'i shikojë ato pjesë të turpshme, sepse atyre u ndalohet. Karakteri i fesë Islame nuk e lejon, sepse kjo quhet një paturpësi.

Si përfundim, Mjeshtri Madhështor ka shumë Emra të Bukur dhe secili ka një Shkëlqim të Vetin, siç është emri: “Gjithëfalës”, që e bën të nevojshme ekzistencën e mëkateve, emri “Mbulues”, që e pranon qënien e gabimeve, po kështu edhe emri “i Bukur”, që nuk dëshiron t'i shohë gjërat e shëmtuara. Emrat, “Bujar”, “Fisnik”, “i Plotmëshirshëm” dhe “i Urtë”, dëshirojnë t'i shohin krijesat brenda mundësisë, në gjendjen e tyre më të mirë. Këto Emra të Bukur dhe të Përsosur, nëpërmjet qenieve, melekëve dhe shpirtërave, xhindëve dhe njerëzve, duan të shpalosin bukuritë, që t'i shohin ato në cilësinë e tyre më të lartë. Tani, synneti i Pejgamberit Fisnik (a.s.m.) dhe karakteri i Tij i ndershëm është simboli dhe principi i karaktereve të treguara më lart.

Pika e tetë: Shiko këto ajete:

(1) فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ

(2) لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ

pra profeti ynë i cili ndaj popullit të vet tregon mëshirën e pasosur dhe dhimbshurinë e paskajshme.

(1) فَإِنْ تَوَلَّوْا

Kuptimi i gjerë i këtij ajeti thotë: “O ju njerëz, o ju muslimanë, çfarë dëmi keni, që i kundërviheni një Pejgamberi, që tërë fuqinë e ka harxhuar për ju dhe me një mëshirë të pafundme po mundohet t'iu tregojë rrugën e drejtë, me dëshirën që t'iu shërojë plagët e shpirtit me melhemin e Tij të fesë së vërtetë e të përsosur, duke reflektuar ndaj jush sjellje dhe logjikë të lavdërueshme? Pse e mohoni mëshirën dhe dhimbshurinë dhe i

kundërviheni gjykimit të Tij? Ai ka sakrifikuar jetën e Tij, për t'iu ndihmuar, kurse ju a e dini se po bëni një marrëzi të madhe me qëndrimin tuaj?” Dhe më poshtë ky ajet vazhdon duke thënë: “O Ti Profet i Dhimbshëm dhe i Dërguar i Mëshirshëm, ata duke mos u menduar gjatë i kundërvihen mëshirës dhe dhimbshurisë tënde, por mos u mërzit, se All-llahu i Madhëruar ty të mjafton. Sundimi dhe Mbretërimi i Tij arrin deri tek Arshi i Madh dhe Urdhëri i Tij zbatohet nga të gjithë ushtarët, në qiell dhe në tokë. Ai në çast mund t'i sjellë rreth Teje shërbëtorët e përulur dhe t'i urdhërojë që të dëgjojnë Ty. Ata e pranojnë këtë shans me kënaqësi”. Pra në Kushtetutën e Muhammedit (a.s.m.) dhe në synnetin e Ahmedit (a.s.m.) nuk ka asnjë çështje që të mos ketë sado pak dobi. Unë me varfërinë dhe me dobësinë time dëshmoj dhe jam gati për tua vërtetuar. Për këto çështje kam shkruar gati shtatë-tetëdhjetë libra të Risale-i Nurit dhe në të gjitha jam përpjekur të pasqyroj ligjet e “shariatit” dhe rrugën, synnetin e Pejgamberit (a.s.m.). Këto libra janë dëshmitarët e mi të vërtetë, aq sa mund të jenë tetëdhjetë dëshmitarë të drejtë. Sikur të isha edhe më i aftë, përveç këtyre librave, jo tetëdhjetë, por me mijëra libra të tjerë do të shkruaja për të pasqyruar dobitë e Tij. Kjo për vetë faktin se dobitë e Tij nuk kanë të sosur. Këtë e kam vërtetuar gjatë shkrimit të këtyre librave, ku sa herë që zbuloja një çështje, një tjetër edhe më e rëndësishme fillonte të shfaqej. Kjo tregon se çështjet e Ligjit të fesë dhe principet e synneteve të Muhammedit (a.s.m.), sidomos për sëmundjet shpirtërore e ato të mendjes dhe veçanërisht ato shoqërore, janë shumë të efektshme, sepse më kanë shëruar edhe mua. Përkundrazi principet dhe ligjet e filozofisë, vendin e shariatit dhe të synneteve nuk mund ta zënë kurrë.

Unë kështu e di dhe jam i bindur, prandaj edhe dikujt i kam thënë se kush dyshon në dëshminë time, le të paraqitet dhe të lexojë librat e Risale-i Nurit. Si përfundim, Ligjeve dhe synnetit të këtij personi të ndershëm, t'iu kushtoni vëmendje sa të jetë e mundur. Sa më shumë, aq më mirë është për ju dhe aq më shumë dobi iu sjell për këtë jetë, po ashtu edhe për atë të përtejmen. Kjo është një kënaqësi e madhe, që ju do ta provoni.

Pika e nëntë: Çdo njeri nuk mund ta arrijë përjetimin e të gjitha shkallëve të synnetit të Pejgamberit (a.s.m.), sepse që ta ketë këtë shans duhet të bashkojë diturinë e thellë me devotshmërinë. Për ne është e rëndësishme, që të përpiqemi dhe të japim kontributin tonë, për ta forcuar këtë anë, që duke na parë neve edhe të tjerët ta pëlqejnë. Për të kryer farzet dhe vaxhibet e kemi të domosdoshme, por duhet të bëjmë edhe ibadetin e synneteve, megjithëse edhe kush nuk i bën nuk ka gjynahe, por humbet shumë nga sevapet. T'i ndryshosh ato është një gabim i madh, por që të mbështetësh në traditat dhe rregullat e Tij, do të thotë se traditat e tua i ke shndërruar në ibadet. Po nuk i bëre, nuk gjykoresh, por të pakësohet drita, prej Dritës së të Dashurit të All-llahut xh.sh.. Të bësh sugjerime në gjykimin e adhurimeve të Pejgamberit (a.s.m.) është “bid'at”, i cili kundërshtohet me ajetin:

(1) **أَلْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ**

Tarikatet (rrugë të devotshmërisë së shumëllojshme), kur nuk shmangen nga drejtësia e fesë islame me adhurimet e shumëllojshme të tyre, nuk prishin punë. Por në shumë vende

të Risale-i Nurit kam thënë se kjo kohë, nuk është koha e tarikateve, sepse në këtë shekull me sulmimin e filozofëve materialistë, besimi është dobësuar dhe duhet ta forcosh atë me argumente shkencore. Mendimi i disa dijetarëve të fesë islame për këtë kategori njerëzish, është se kanë kaluar në “bid’at”. Ky lloj “bid’ati” nuk është “bid’ati seje”, i dëmshëm, por “hasene” (jo i keq). Përsëri me të drejtë, këtë gjë e ka përsëritur Imami i mijëvjeçarit të dytë Rabbaniu, kur thotë se, “Unë duke vizituar botërat e shpirtërave, kam vënë re se, ata që janë mbështetur në fjalët që janë transmetuar nga Resulull-llahu (a.s.m.), pra në synnetet e tij, shndrisin shumë. Disa rite të forta të adhurimit, që nuk mbështeteshin tek synneti i Pejgamberit (a.s.m.), nuk shkëlqejnë dhe me të parën nuk mund të krahasoheshin kurrë. Atëhere e kuptove se edhe vlera e adhurimeve që burojnë nga ky synnet i Pejgamberit (a.s.), ndikimin e kanë shumë të madh dhe të fortë. Kush kërkon nur (dritë), prej këtij synneti, i mjafton Drita e Tij. Nuk është e nevojshme që dikush të kërkojë dritë jashtë dritës së tij. Tani që e pe gjykimin e Heroit i cili është një person i ndershëm dhe ekspert i kësaj fushe, sipas pikëpamjeve të Imamit Rabbani del se synneti i Pejgamberit është guri themelor për të dy jetët, si dhe miniera e përsosmërisë.

اللَّهُمَّ ارْزُقْنَا اتِّبَاعَ السُّنَّةِ السَّيِّئَةِ رَبَّنَا آمَنَّا
بِمَا أَنْزَلْتَ وَاتَّبَعْنَا الرَّسُولَ فَكُنْ بِنَا مَعَ الشَّاهِدِينَ (1)

Pika e dhjetë:

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ (2)

Në këtë ajet të mrekullueshëm ka shumë domethënie, sepse në këto fjalë janë përmbledhur shumë ide të vlefshme. Ky ajet thotë: “Në qoftë se besoni tek All-llahu xh.sh., patjetër do ta doni Atë. Meqenëse do ta doni me të vërtetë, brenda dëshirës së Tij do të veproni, pra do të përpiqeni t’i ngjani Personit të Ndershëm, që Dashuria e Profetit (a.s.m.), bashkohet me Atë të All-llahut xh.sh.. Duke i ngjarë atij me vetëdije, duke iu përshtatur rrugës së tij dhe duke ndjekur synnetin, patjetër që edhe All-llahu xh.sh. do t’ju dojë me të vërtetë. Për të fituar Dashurinë e All-llahut xh.sh. duhet ta duash atë, Pejgamberin (a.s.m.)”.

Tani e kuptojmë se qëllimi më i lartë i njeriut është që të fitojë Dashurinë e All-llahut xh.sh.. Ajeti i mësipërm tregon se rruga për të plotësuar këtë dëshirë kalon nëpërmjet mbështetjes në synnetin e Resulull-llahut (a.s.m.). Në këtë pozitë, në rast se vërtetojmë tre pika, e vërteta del në shesh plotësisht.

E para. Njerëzit janë krijuar mbi dashurinë e pafundme ndaj Krijuesit të Gjithësisë. Njeriun në ekzistencën e tij nuk mund ta ndash prej shkaqeve, të cilat do t’i japim më

poshtë. Ai e do dashurinë, i do gjërat e bukura, por e dëshiron edhe përsosmërinë. Ndaj Bamirësit të tij mundohet të shprehë dhe të sqarojë dëshirën dhe zellin e tij. Sipas shkallës së bukurisë, përsosmërisë dhe bamirësive, dashuria i shtohet dhe shkon deri në kulmin e të gjitha dashurive. Në zemrën e vogël të këtij njeriu të imët, zë rrënjë një dashuri e tillë e madhe, sa ç'është e gjithë gjithësia. Pra truri i njeriut që është një senduk i zemrës, mban me mijëra libra, pothuaj një bibliotekë të tërë, ku vendi i mbajtjes nga pikëpamja materiale, nuk është më tepër se sa një kokërr gruri. Kjo tregon se kjo zemër kaq e vogël është në gjendje të përmbledhë në vetvete të gjithë gjithësinë. Në këtë rast, shkalla e dashurisë lartësohet shumë. Njeriu ka aftësi të pafundme për të adhuruar bukurinë, të bëjë bamirësi dhe të përsoset. Duke parë këto bukuri reale të gjithësisë, ai ka parë edhe Bukurinë e Vërtetë dhe të Pastër, tek e cila janë pasqyruar këto bukuri. Po kështu, tek këto qenie ku janë shpallur artet me të gjitha finesat e tyre të shumëllojshme dhe të përsosura, tregon se me një saktësi të padyshimtë, ato pasqyrohen tek Një i Përsosur Madhështor. Duke vazhduar më tej, tek këto qenie të gjalla tregohet një Bamirësi e Pafundme dhe e shumëllojshme dhe një njeri i mençur, tek të gjitha këto nimete të pafundme, do të shohë Mëshirën e Bamirësit të vërtetë. Patjetër që prej njeriut që është me një vetëdije universale, i gjendur, i dashur dhe i vëmendshëm, pritet një Dashuri e Pafundme. I takon njeriut që me një zell të madh ta dojë Krijuesin Madhështor, që është edhe Krijuesi i të gjitha qenieve të varfëra dhe të pafuqishme. Më tepër se askush tjetër, përballë Bukurisë së Pakufishme dhe Përsosmërisë së Pafundme si dhe Bamirësisë së Pashtrërshe, njeriu karakterizohet nga një dëshirë dhe zell i madh. Përderisa njeriu besimtar, që e do jetën, përjetësinë dhe i beson ekzistencës së jetës së mbrapme, duhet ta dijë se këto qenie të lloj-llojshme të qendisura, janë një shkëlqim prej bukurisë së asaj jete dhe një thërrmi, prej aftësisë dhe dëshirës së All-llahut xh.sh.. Tek njeriu vihen re ndjeshmëri të ndryshme, që nuk janë tjetër veçse transformim i kësaj Dashurie. Nga eksperiencia dihet se njeriu siç interesohet për lumturinë e vet, po ashtu interesohet edhe për atë të njerëzve me të cilët ka lidhje të ngushta. Ashtu siç i do ata që i ka shpëtuar nga fatkeqësia, po ashtu i do edhe ata të tjerët, që iu ka bërë të mira. Me këtë ndjeshmëri të shpirtit, këto mirësi të All-llahut xh.sh. jo vetëm që duhet t'i kujtojë, por thellësisht duhet të mendojë në këtë mënyrë: "Krijuesi im ashtu siç më ka shpëtuar nga errësira e përjetshme dhe më ka dërguar në një botë të bukur, po kështu edhe në të ardhmen mua do të më vendosë në parajsën e bukur dhe nuk do të më internojë në ndonjë vend të keq apo asgjëshmëri, por si mysafir, në vendin e lumturisë së përjetshme. Atje do të kënaqemi me të gjitha shqisat tona të dukshme dhe të padukshme. Jo vetëm unë por të gjithë të afërmit e mi do t'i kënaqë që unë në këtë botë i kam dashur aq shumë dhe jam interesuar për fatin e tyre. Pra të gjitha ato mirësi që janë bërë për ta, janë shënuar në interesin tim. Kjo ndodh sepse nga kënaqësitë që u ka sjellë atyre edhe unë vetë ndihem shumë kënaqur. Fshehtësia e kësaj fjale të urtë thotë:

① الْإِنْسَانُ عَبِيدُ الْإِحْسَانِ

Përballë të gjithë këtyre mirësive që janë në dobinë time edhe sikur ta kisha zemrën sa e tërë gjithësia, do ta kisha mbushur katërcipërisht me dashurinë ndaj Atij, që m'i ka sjellur këto mirësi të pafundme. Unë me punë ndoshta këtë nuk arrij ta plotësoj, por me besim,

aftësi, qëllim, pranim, përkushtim dhe vullnet, i duhet t'i përgjigjemi Dashurisë për Bukurinë dhe Përsosmërinë e Pafundme. Në këtë tregim e kupton më mirë se mosbesimtari me anë të mosbesimit të tij, mban një armiqësi të paskrupullt jo vetëm me Krijuesin por bile me të gjitha qeniet.

E dyta. Dashuria ndaj All-llahut xh.sh. e bën të nevojshme mbështetjen edhe tek Profeti Fisnik (a.s.m.) dhe tek synneti i Tij. Për këto vepra, atë e do All-llahu xh.sh. sepse kush e do All-llahun xh.sh. duhet t'i bëjë ato vepra që i do Ai, duke vepruar sipas Hirës së Tij. Hiri i All-llahut xh.sh. më së miri është sqaruar tek i Dërguari Fisnik (a.s.m.). Dashuria që mban Profeti Muhammed (a.s.m.) mund të sqarohet me këto dy punë. Njëra për të sqaruar dashurinë ndaj All-llahut, duke u mbështetur tek mesazhet që ka sjellë Profeti (a.s.m.) dhe duke iu bindur Urdhërave të All-llahut xh.sh.. Në mënyrë të përsosur sqarohet dashuria ndaj All-llahut xh.sh dhe Profetit të Tij (a.s.m.), sepse Dashuria e Vërtetë kalon vetëm nëpër këtë rrugë.

Tjetra meqenëse Profeti ynë (a.s.m.) është shkaku i shpalljes së të gjitha Mirësive të All-llahut xh.sh., në këtë mënyrë Ai e meriton dashamirësinë e pafundme.

Si shembull: Për shkak se është brenda mundësive, njeriu përpiqet të imitojë Dashamirin e vet dhe të veprojë si Ai.

E treta. All-llahu i Madhëruar siç e ka Mëshirën të Pafundme, ashtu edhe Dashurinë ndaj nesh e ka të pafundshme. Ai tërheq për nga Vetja dashamirësinë tonë, duke na shpalosur sipërfaqen e tokës të zburuar me qëndisje të lloj-llojshme. Ai gëzohet duke na parë neve të lumtur nga soditja e Arteve të Tija të mrekullueshme dhe me Stoli të Pafundshme. Bukurinë e më të Bukurit do ta vëresh, atëherë kur të shikosh që: I gjithë Xhenneti është një shkëlqim i tërë bukurive të larta, i mbushur me zëra të ëmbël dhe i mbështjellur nga një shkëlqim i ndritur, prej Mëshirës së Allahut xh.sh.. A e kupton se sa e rëndësishme është që ta sjellësh për nga vetja Dashurinë e All-llahut xh.sh.? Edhe në ajetet e Kur'anit është theksuar se Dashuria e All-llahut fitohet me mbështetjen tek synnetet e Resulull-llahut (a.s.m.). Ne theksuam se qëllimi më i madh i njeriut, duhet të jetë mbështetja ndaj Pejgamberi (a.s.m.).

Pika e njëmbëdhjetë:

Kjo pikë përmban tre çështje:

E para burimet e synneteve të Resulull-llahut (a.s.m.) janë tre: Fjalët, Veprat dhe Pozicioni i Tij. Edhe këta tre burime ndahen në tre të tjera: Farzet, Nafilet dhe Sjellja e Tij e mirë. Është e domosdoshme që të mbështetemi tek "Farzet" dhe "Vaxhibet". Kush i braktis këto, meriton dënime të rrepta. Ato duhet t'i kryejë secili. Për nafilet, që nuk janë urdhëra të All-llahut xh.sh., mirë është që të tregohesh dashamir ndaj tyre, sepse këtë gjë e urdhëron dashuria ndaj islamit por edhe mos t'i kryesh nuk ke dënim. Në qoftë se i kryen këto, ke fituar sevape të mëdha, por po i shndërrove me shpikje të ndryshme, bid'ate, është një gabim i madh. Kush e pëlqen traditën dhe trajtesën e tij të bukur në jetën shoqërore dhe individuale ai ka bërë një dobi të madhe, sepse në një traditë të thjeshtë të tij, gjendet një interes i veçantë jetësor. Pra kush mbështetet në Të, këto tradita

i ka shndërruar në adhurim. Faktin që Morali i tij ka qenë në shkallën më të lartë, e dëshmojnë miqtë dhe armiqtë e tij. Mendimi unik i të gjithë njerëzve të shquar, ka këtë pikë takimi: “Muhammedi (a.s.m.) është njeri i Posaçëm dhe i Shquar”. Nga shënimi i njëmijë Mrekullive të Tij dhe nga dëshmia e popullit mysliman është më se e qartë se Ai mbetet njeriu më i Përsosur. Ai është kumtuesi dhe përkthyesi i të vërtetave të Kur’anit. Edhe Kur’ani e vërteton se ky njeri është udhërrëfyesi më i pagabueshëm dhe më i Përsosur. Kur’ani me anë të të Dërguarit ka dhënë miliona frute të përsosura, si një fushë studimi për përparimin e njerëzimit. Pra ai dhe Rruga e Tij, janë një shembull i mirë për t’u ndjekur. Duke e ndjekur, si udhëheqësin më të përsosur, principet e Tij të sakta të joshin. Është fatbardhë ai që ka marrë sa më shumë pjesë në synnetet e tija, kurse kush vepron si vagabond dhe nuk mbështetet tek Rruga e Pejgamberit (a.s.m.), ka pësuar humbje të rëndë. Kush i nënvlerëson këto principe, ka bërë një krim të madh, kurse ai që gënjen dhe kritikon, ka pëlqyer rrugën e kundërt.

E dyta, All-llahu xh.sh. në Kur’anin e Tij të Famshëm thotë:

(1) وَإِنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ

Në transmetime të sakta, Hz. Aishe duke sqaruar moralin e Hz. Muhammedit (a.s.m.) ka thënë: “Morali i tij është morali i Kur’anit.” Pra ai e shëmbëllen moralin e Kur’anit, tek i cili është pasqyruar përsosmërisht. Këto Bukuri të Larta, më parë se kushdo i ka përjetuar Hz. Muhammedi (a.s.m.). Kjo është arsyeja që të gjitha fjalët, veprimet, sjelljet dhe mënyra e lëvizjeve të Tija, janë si një model i përkryer për njerëzit që duan të arrijnë në lartësinë e duhur të njerëzimit. Mjerë për ata që nuk i kanë besuar atij dhe jetojnë pa u dhënë rëndësi synneteve të Tij. Bile aq më keq për ata që duke vazhduar një jetë të pakujdesshme, mundohen t’i prishin këto synnete. Ata nuk janë gjë tjetër veçse ca reformista injorantë dhe të shushatur. Askush nuk e kupton se sa rënie e madhe është kjo gjendje.

E treta profeti ynë, përveç se është krijuar si një shembull i pajisur me mjetet më perfekte, vetë biografia e Tij flet edhe më qartë se ai erdhi në formën e një mjeti të përsosur. Dukuria dhe veprimet e Tij kanë qenë me një orientim të mesëm. Ai kurrë nuk ka pëlqyer rrugën e dhive, të ngushta, të gjaknxehtësisë apo të vendqëndrimit. Ai vazhdimisht ka pëlqyer bulevardin e gjerë të Drejtësisë. I Dërguari Fisnik (a.s.m.), se në çfarë drejtësie mishërohet më së miri, tregohet me këtë ajet:

(1) فَاسْتَقِمْ كَمَا أُمِرْتَ

Në të gjithë jetën e vet, ai me fjalë, vepra dhe sjellje, kurrë nuk është ndarë prej rrugës së të drejtës së mesme. Për shembull, errësira e mendjes që paraqitet si një formë e gjaknxehtësisë të një pamaturie, rrëmbimi, apo gjakftohtësie, është një vendqëndrim apo si një mpirje e mendjes. Profeti (a.s.m.) ka qenë larg këtyre mentaliteteve të papëlqyera.

Ai ka qenë i pastër, me një dituri të kulluar dhe ka ndjekur rrugën e drejtë. Sipas Tij, kur të rrëmbejnë shpërthimet nervore, për pasojë mund të biesh në mizori, fjalamanëri dhe frikësim. Ai u është larguar këtyre ngasjeve dhe i është përmbajtur trimërisë dhe vendosmërisë. Gjithmonë ka qëndruar larg ngatërresave të nefsit dhe veseve të palejuara, duke qenë i palëkundur në të lejuar. I Dashuri i Zotit xh.sh. e ka vazhduar rrugën e jetës duke pasur si busull orientimi sedrën, nderin dhe pafajshmërinë. Siç e kemi theksuar edhe më parë, në tërë veprimtarinë e Tij individuale dhe në zbatimin e Ligjeve të Drejtësisë së Fesë, ka pëlqyer rrugën e drejtësisë së mesme pa e vlerësuar atë të errësirës së tepërt të së kaluarës dhe të së ardhmes. Ashtu siç ka qenë i kursyer në ekonomi, në shpenzime, ngrënie dhe pije, po ashtu ka qenë shumë i matur edhe në të folur. Për sqarimin e këtyre çështjeve janë shkruar mijëra libra.

(1) الْعَارِفُ تَكْفِيهِ الْإِشَارَةُ

Prandaj ne do të mjaftohemi vetëm me një pikë, për të treguar oqeanin.

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى جَامِعِ مَكَارِمِ الْأَخْلَاقِ وَمُظْهِرِ سِرِّ
 (وَإِنَّكَ لَعَلَى خَلْقٍ عَظِيمٍ) الَّذِي قَالَ : مَنْ تَمَسَّكَ
 بِسُنَّتِي عِنْدَ فَسَادِ أُمَّتِي فَلَهُ أَجْرُ مِائَةِ شَهِيدٍ ﴿١﴾ الْحَمْدُ
 لِلَّهِ الَّذِي هَدَانَا لِهَذَا وَمَا كُنَّا لِنَهْتَدِيَ لَوْلَا أَنْ
 هَدَانَا اللَّهُ لَقَدْ جَاءَتْ رُسُلٌ رَبِّنَا بِالْحَقِّ ﴿١﴾

BESIMI DHE TARIKATI

Siç çdo koha që ka problemin e saj, njësoj edhe në këtë kohë problemi më i madh i besimtarëve është duke argumentuar dhe duke bindur ta forcoje besimin, që të mos mashtrohen dyshimeve që impunojnë mohimtarët. Jam i bindur se nuk mundeni ta mohoni se sot besimi i shumicave ka marur plagë.

Sot dikush po mundohet të hyje në donjë tarikati që është mbrenda ehli synnetit, ky njeri mund të shpëtoje vehten, por ma tregoni nga tarikati çka mundet mi dhënë djemve dhe vajzëve tij që studjojnë natyralizmin e materjalizmin., që mësusi atyre u thotë mos zini besë atyre sendeve që nuk e shihni me sy.

Tarikati ka pasur vlerë më një kohë që ka sunduar drejtësia e fesë islame, që në atë kohë njerëzit kanë pasur besimin e fort, në atë kohë urdhërat e Allahut afër 100% janë zbatuar, e në atë kohë njerëzit sa më tepër të edukojnë nefsën dhe të lartsohet me devotshmeri janë munduar sa më tepër ta përmendin All-llahun duke bërë dhiqër. Por në këtë kohë tarikatat kanë humbur vlerën shumë. Këtu më poshtë do të shihni Bedüzzaman Said Nursi si tregon fjalët e heroit dhe diellit të tarikatit të Nakshibendive Imami Rabbaniut (k.s.)

LETRA E PESTË

بِسْمِهِ سُبْحَانَهُ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ

“Me emrin e All-llahut të patëmeta. Nuk ka asnjë send që nuk e përmend duke i shprehur falenderiome Atij”.

Heroi dhe dielli i tarikatit nakshibendi Imami Rabbani (k.s.) në librin e tij “Mektubat” ka thënë: Zbulimin e një çështje të vetme të besimit islam, e parapëlqej ndaj mijëra shijeve të zemrës që rrjedhin nga keramete (mrekullitë) shejtarisë.

Duke vazhduar ka thënë se: Qëllimi dhe pikësnyimi më i lartë i të gjithë tarikateve është tek arritja tek zbulimi i çështjeve të besimit.

Në vazhdim ka thënë: Evlijalëku (shenjtaria) ndahet në tre pjesë: I pari është evlijalëku i vogël për të cilin shume njerëz vrapojnë pas saj. I dyti është e mesmi. I treti është i larti. Kjo e fundit pa hyrë nëpër rrugë misteke të tarikateve, për të arritur të vërtetat vijon nëpër rrugët të Peygamberisë. Prap thotë: Në tarikatën e nakshive përparohet me dy krahë: E

para më një besim të fort ndaj kushteve të besimit, e dyta t'i krijosh farzët e urdhëruara. Në këto dy krah kush ka mangësi, ai nuk mund të lëvizë në tarikatin e nakshive.

Meqë është kështu, si përfundim del se: Tarikati i nakshive lëvizë nën tre perde: E para dhe më e rëndësishmja dhe më e madhja e pikëmbështetjes së tyre është shërbimi ndaj të vërteve të besimit, që edhe Imami Rabbani nga fundi i moshës së tij eka parapëlqyer këtë rrugë. E dyta nën perden e tarikatit t'u shërbesh farzeve dhe synneteve. E treta me „tasavvuf“ (misticizëm) nëpër rruga të ndryshme të edukosh nefsën dhe duke pastruar nga mëkatet të mjekosh zemrën, pra me këmbën e zemrës të përparosh në rrugën e evlijalekut. Pra e para është farz, e dyta është vaxhib e treat e merr gjukimin e synnetit.

Meqë është kështu, unë mendoj se sikur të ishte gjallë shejh Gejlani (k.s.) prijësi i tarikatit Kadiri dhe imami Rabbani (k.s.) tërë fuqinë e tyre do të shpenzonin që të forconin besimin dhe bindshmerinë e njerëzve tek themelet e besimit të fesë islame. Po që se nëpër to ka gabime bëhet shkak i ndëshkimit të përgjithëmshëm. Sepse pa besim nuk shkohet në xhennet por pa misticizëm dhe pa hyrë në tarikat shumica ekan fituar xhennetin. Njeriu pa buk s'mund të jetoje por pa frutë jetohej. Tarikati është frut, kurse të vërtetat e besimit janë ushqim themelor. Prandaj në të kaluarën, për të mësuar një të vërtetën e besimit kishte nevojë për një periudhë të gjatë të moshës që fillonte nga dyzet ditë e shkonte në dyzet vjet dhe me vështirësi mundeshin të arrijnë që ti mësojnë disa të vërtetat e besimit. Tani me mëshirën e All-llahut xh.sh., po që se ekziston një rrugë e shkurtër për të arritur drejt atij qëllimi në një kohë prej dyzet minutash, si thoni a është mençuri që njeriu të jetë i pa kujdesshem ndaj kësaj rruge?...

Pyetje? Çfare argumenti na paraqet për këtë? Tani tridhjetë e tre “Fjalët” e Risale-i Nurit (tërësisht janë njëqindë e tridhjetë fragmente) kush i ka lexuar po dëshmon se është hapur kështu një rrugë e Kur'anit. Meqë e vërteta është kështu, sekretet e Kur'anit nga të cilët kan rrjedhur fjalët e Risale-i Nurit, janë ilaçe të efektshme dhe një melhem të pëlqyeshëm për plagët e kësaj kohe. Gjithashtu për popullin musliman që është ballafaquar me sulmet e errësirave të mosbesimit, kjo është një dritë tepër e shëndritshme. Unë jam i bindur se kjo rrugë është rruga më e drejtë dhe një udhërefyese e pa shoqe, veçanërisht për ata që vrapojnë nëpër lumenjtë e dyshimeve që s'kanë dalje. E dini mirë se nëqoftë se dikush e humb rrugën nga mosdija shumë lehtë atij i drejtohet rruga, po që se njeriun shkencat materialiste e kanë futur në mos besim, atëhere për këtë fundit (materialistët) mjekimi është i vështirë. Në të kaluarin një në një mijë kan devijuar nga marerializmi dhe prej tyre një në një mijë ka pasë mundësi të hyjë në rrugën e duhur. Sepse ato pëlqejn mendimet e veta dhe duke mos njohur veten luajn rolin e dijetarit. E falenderoj shumë All-llahun xh.sh., që nga shkëlqimet e mrekullive të Kur'anit, na ka dhuruar shkëlqimet e mrekullive të Risale-i Nurit që janë parashtruar në formë Fjalësh nga një melhem (ilaç) i efektshëm ndaj mosbesimtarëve të shturur mendimi im është në këtë drejtim.

I pavdekshëm është vetëm Ai (All-llahu).

KËTU DO TË PARASHGTRON DËSHMIMET E FILOZOFËVE FAMSHËM TË AVROPËS, KU TREGOJNË SE KUR'ANI ËSHTË NJË LIBËR I VËRTETË DHE MUHAMMEDI (A.S.M.) NJË PERSON I POSAÇËM

* * *

Dëshmia e Princ Bismarkut.

O MUHAMMED (A.S.M.), PËR ARSYE SE NUK KAM PASUR FATIN TE PËRJETOJ SHEKULLIN TËND, JAM SHUMË I MJERUAR!

Megjithëse gjerësisht i kam hetuar të gjitha librat që thuhet se janë hyjnorë dhe qiellorë, për arsye se janë përballuar me fallsifikime, tek asnjëri nuk kam mundur të gjej përpikmërinë që kam kërkuar. Në fund mora vendimin se këto libra jo një popull, por as lumturinë e një familjeje nuk mund ta garantojnë. Kurse Kur'ani i Muhammedive ishte larg prej këtyre. Sepse unë e hetova Kur'anin gjithësisht dhe në secilën fjalë u përballova me dobi dhe të vërteta të mëdha, megjithëse armiqtë e Muhammedive thonë se Muhammedi (a.s.m.) vetë e ka shkruar. Por mendja e pastër ato thënie nuk i pranon kurrë, sepse asnjë logjikë superiore nuk mund të japë këtë prodhim. Ky mendim kundërshtohet me të vërtetën dhe diturinë reale, sepse në qoftë se dikush mbyll sytë ndaj të vërtetave të pamohueshme, ka bërë një gabim të madh. Unë pohoj se Muhammedi (a.s.m.) është një fuqi e posaçme. Sepse diçka e tillë nuk është e mundur në botën e qenieve. Le të paraqitet një fuqi tjetër si ky.

O Muhammed (a.s.m.), për arsye se nuk kam pasur fatin të përjetoj shekullin tënd, jam shumë i mjeruar. Ti që je mësuesi dhe shpallësi i Kur'anit Famëlartë, Ai nuk është prodhimi i yt, por është një libër hyjnor. Ta mohosh këtë fakt, është një marrëzi dhe i ngjan mohimit të të gjitha shkencave. Kështu, Ty njerëzimi njëherë të ka parë, nuk është e mundur më të të shohë. Unë duke shpallur nderime, dashuri të sinqertë dhe të përsosura, të përkulem ty.

Princ BISMARKU

●

Më e drejtë dhe më pastër është feja Islame!

Autori i famshëm, orientalisti, eksperti i letërsisë arabe dhe përkthyesi i Kur'anit të famshëm, doktor MAURICE thotë:

Të krishterët e Romës mund t'i nxjerrë nga rruga pa dalje ku kanë rënë, vetëm zëri që është lartësuar në malin e Hirës së arabëve. Ai mal është që zërin hyjnor e ka lartësuar në vendin e duhur, në atë të më të lartëve. Por rumët (romakët), këtë zë nuk e kanë dëgjuar kurrë. Kurse ky zë njerëzve ua ushtron fenë më të pastër dhe më të drejtë. Ajo fe që ndaj njerëzve të tillë si Gundö Firej Hesin, hetues i shquar, me të drejtë të plotë ka thënë këto

fjalë: “Uji i bekuar, rrobat e shenjta, kryqet dhe shenjtorët, besimet që janë të lidhura fort tek gjëra të zhveshura nga veprat e mira, fjalë që supozohen të vlefshme në çastin e vdekjes, apo lutje të tjetërkujt për t’u bërë shkak shpëtimi për mëkatarët, nuk ekzistojnë në fenë islame. Këto besime të kota janë shkak i poshtërimit të tyre”.

Sa më tepër po kalon koha, aq më tepër po zbulohen sekretet e Kur’anit.

Doktor Maurice (Morris) ne gazetën që titullohet “Le parler Française Roman”, i është përgjigjur kështu kritikuesit Selman Ruhah, përkthyes i Kur’anit në gjuhën franceze:

Çfarë është Kur’ani? Kur’ani është një mrekulli, një elokuencë dhe gojtari e madhe mbi të gjitha kritikata. Kur’ani është një shkak mburrje të drejtë në gjoksat e treqind e pesëdhjetë milionë muslimanëve. Jo me kaq, por mund të vazhdojmë edhe më tej:

Fuqia e përjetshme e All-llahut xh.sh., Kur’anin e madhëruar e ka zgjedhur si librin më të bukur për njerëzit, në pikëpamjen e rehatisë së njerëzimit. Kur’ani Famëlartë është shumë më i lartë se sa tregimet e filozofëve grekë. Ai është plot e përplot me falenderime ndaj Krijuesit të tokës dhe të qiejve. Secila fjalë e Kur’anit është fjala e Zotit xh.sh., Fuqia e të Cilit mund të krijojë çdo gjë. Për ata që merren me letërsi, Kur’ani është një libër letrar. Për ata që janë ekspertë të gjuhës, Ai është një thesar i shprehjeve. Për poetët është një peshore harmonie. Përveç këtyre që treguam, në bazën e gjykimeve të drejtësisë, Ai është një fushë diturie. Po ta marrësh nga koha e Profetit Daut (a.s.), e deri në kohën e Jan Talmusit, asnjë libër i dërguar nuk ka mundur të hyjë në konkurrencë me ajetet e Kur’anit. Për këtë arsye klasat e sipërme të muslimanëve, në pikëpamjen e jetës sa më tepër që të përparojnë, aq më tepër lidhin kontakt me Kur’anin Famëlartë. Përparimi tek muslimanët barazpeshohet me shpalljen e nderimit të tyre ndaj Kur’anit Famëlartë.

Në këtë mënyrë ditë përditë, ndaj Kur’anit u shtohet nderi i muslimanëve. Bile shkrimtarët islam, i zbukurojnë, duke i frymëzuar shkrimet e tyre me ajetet e Kur’anit të famshëm. Besimtarët sa më tepër lartësohen duke studiuar dhe u edukuar, aq më tepër mendimet e veta mbështeten në Kur’anin Famëlartë. Muslimanët janë dashuruar me librin e vet dhe me sinqeritet të zemrës, Kur’anin e quajnë si libër të amshueshëm. Kurse popuj të feve të tjera qiellore, as i japin librave rëndësi e as nuk i nderojnë librat e tyre. Por muslimanët nuk barazohen me ta, sepse librat e tyre i nderojnë për shkak se janë të bindur se gjykimi i Tij, sundon deri sa të qëndrojë bota dhe në këtë mënyrë nuk do të nevojiten udhërfyesh të tjerë kurrë. Në të vërtetë elokuenca, gojtaria dhe pastërtia e Kur’anit, atë e ngre në një pozitë të posaçme, për këtë arsye ata nuk kërkojnë ndonjë gojtari tjetër. Është e ditur se gjenitë e letërsisë dhe poetët e lartë kanë shpallur dobësinë, duke u përkulur para Kur’anit Famëlartë. Çdo ditë dritat e bukurisë së Kur’anit, po shkojnë duke shkëlqyer dhe vlera e Tij po del në pah më tepër, duke mos u sosur të fshehtat e tij. Muslimanët duke qenë popuj të famshëm në prozë dhe poezi, ndaj stilit të Tij janë detyruar të bien në gjunjë. Muslimanët besojnë se Kur’ani posaçërinë e Tij do ta përjetojë deri në ditën e mah’sherit. Dhe kanë të drejtë në mendimin e tyre. Muslimanët atë e përngjasojnë me një lum që gufon dhe frymëzohet me fjalët e gojtarisë dhe të kuptimeve të holla. Nëse Monsieur Renaudit i bie rasti të takohet me botën islame, muslimanët do t’i shikonte në formën më të ndritur dhe të edukuar, sepse ata parashirojnë nderime të larta ndaj Kur’anit dhe i bëjnë ballë me respekt të jashtëzakonshëm urdhërave të Tij. Ata duke

u përpjekur të mos dalin jashtë moralit dhe ligjit të Kur'anit, arrijnë në vendin e duhur të njerëzimit. Bile edhe studentët që kanë kryer shkollën e shkencave të sotme, nuk mundën të durojnë ndonjë fjalë intrige kundra Kur'anit. Sepse Kur'ani ka merituar në dy anë këtë respekt:

E PARA: Kur'anin që e kanë sot në dorë, është pa fare ndryshim dhe orgjinal siç i është zbritur Muhammedit (a.s.m.). Kurse ndaj Teuratit dhe Ungjillit janë paraqitur shumë dyshime.

E DYTA: Muslimanët Kur'anin e dinë si mbrojtësin më të madh të gjuhës arabe dhe për ta parashtruar në gjendjen praktike, atë e pranojnë si burim të fesë së vërtetë. Prandaj Monsieur Renaud në qoftë se e korrigjon përkthimin e tij gabim, (Kur'anin), njerëzimin do ta ndihmojë për t'u ndriçuar shumë dhe për të prishur kufijtë e besimeve të kota.

Doktor MAURICE

•

Pastërtia dhe shprehjet e larta të Kur'anit ndaj All-llahut të Madhëruar.

Mister John Davenport, në librin e tij që titullohet "Hazreti Muhammed (a.s.m.) dhe Kur'ani", thotë këto fjalë:

Në veçantitë e panumërta të Kur'anit, dy gjëra janë jashtëzakonisht të rëndisishme:

1- Me lartësinë e ekuilibrit të ajeteve, në momentin kur shpreh emrin e All-llahut të Madhëruar, Kur'ani Famëlartë e lartëson All-llahun xh.sh., duke mos i veshur ndonjë të metë njerëzore.

2- Kur'ani, nga fillimi deri në fund është i pastër nga fjalët e pamoralshme dhe nga ato të thjeshta e të paedukuara. Në të nuk mund të gjesh fjali, apo përrallëza të palogjikshme, përveç gojtarisë së paarritur.

Këto mangësi janë të bollshme në librat e amshuar të të krishterëve.

John DAVENPORT

•

Kur'ani është i mbushur me seriozitet dhe sinqeritet.

Carlyle thotë kështu:

Po qe se vetëm një herë e lexon me kujdes (Kur'anin), do të vëresh se si sqarohen cilësitë e veçanta të tij. Bukuritë e Kur'anit janë përmbi të gjitha veprat letrare të tjera. Kryesorja e cilësive të veçanta të saj, është mbrojtja e origjinalitetit të tij. Unë në këtë mendim jam i bindur se Kur'ani prej fillimit e deri në fund është plot e përplot me të vërteta të sinqerta. Kurse Hazreti Muhammedi (a.s.m.) me ftesën e tij, ka ftuar të gjithë botën tek feja e vërtetë.

CARLYLE

●

Feja Islame e refuzon besimin në trinitet dhe besimet tek gjërat materiale.

Më i madhi autor nga autorët e famshëm të anglezëve Edvard Gibon, në librin “Vetvrasja dhe rrëzimi i Parandorisë Romake”, thotë kështu:

Vendet nga lumi Ganj deri tek oqeani Atlantik, Kur'anin Famëlartë e kanë pranuar si kushtetutë dhe ligj të jetës. Sepse në pikëpamjen e Kur'anit nuk kanë dallim një udhëheqës ngadhënjimtar me një të varfër të mjerë. Kur'ani ka vendosur një sistem të tillë jetësor, që në rruzullin tokësor nuk mund t'ia gjesh shokun. Themelet e besimit Islam refuzojnë bindjen në trinitet dhe veshjen Zotit trup material. Dhe gjithashtu udhëzojnë të mos adhurosh tjetër gjë përveç All-llahut xh.sh.. Këto mendime mistike përpiqen të përhapin mendimet e trinitetit dhe për Mesihun (Isain a.s.), thonë se është bir i Zotit. Kurrë! Por këto mendime vetëm nga mendjet e të krishterëve fanatikë mund të pranohen, kurse Kur'ani i famshëm është i pastër prej këtyre bindjeve të ngatërruara dhe të dyshimta. Kur'ani është më i madhi argument për ekzistencën e All-llahut xh.sh.. Kush beson në një Zot dhe zotëron një logjikë të shëndoshë filozofike, pa menduar fare e pranon pikëpamjen e fesë Islame. Sepse feja Islame është më lart se sa mendimet e zbuluara të sotme.

Edward GIBBON

●

Më së miri feja Islame i ka treguar të drejtat mes All-llahut dhe njerëzve.

Ajo është një përmbledhje e moraleve më të bukura që dalin nga Kur'ani dhe sqarimet e Hz. Muhamedit (a.s.m.). Nevojat e vendeve të ndryshme përballohen duke sqaruar themelet e Kur'anit. Është e pamundur të mohohet se kush ka dashur t'i afrohet All-llahut, më së miri me Të e ka lidhur Kur'ani. Haku i Krijuesit me ato të krijesave të Tij, më së miri sqarohet në Fenë Islame. Këtë fakt jo vetëm muslimanët, por edhe të krishterët dhe musevitë (izraelitët) e pohojnë.

Marmaduke PICKTAHALL

Kur'ani është një libër që pa fare dallim përshtatet me ligjet e natyrës dhe zbulimet e reja.

Me ndihmën e diturisë së shkencave të zbuluara, apo akoma të pazbuluara, asnjë çështje nuk kundërshtohet me themelet e besimit Islam. Përkundrazi me mundimet tona, krishtërimin përqipemi ta sqarojmë që nuk është kundër ligjeve të natyrës. Ligjet e Kur'anit pa fare dallim, përputhen me ato të natyrës. Pra ai është një libër që meriton nderimin.

LEVAZAUNE

●

Kur'ani përmban themelet e të gjitha të mirave dhe njeriun e largon nga të gjitha rrugët e errëta.

Kur'ani njerëzve në një formë më të qartë u ka mësuar se çfarë të drejte kemi ndaj All-llahut xh.sh., qeniet çfarë lidhje kanë me All-llahun xh.sh. dhe çfarë shpërblimi presin nga Krijuesi i tyre. Kur'ani përfshin dhe shpjegon sjelljet e mira, themelet e filozofisë, nderin, paturpësinë, dobitë, dëmet; shkurtimisht ai ka sqaruar cilësitë e të gjitha çështjeve në mënyrë të përmbledhur. Përmbledhja e diturisë së shkencave që është barazjetesë, bamirësia, virtytet e bukura dhe humanizmi, janë ushtruar tek ai. Kur'ani duke e mbrojtur nga rrugët e errësirës dhe veseve të pamoralshme, e ka mësuar njeriun që të vazhdojë jetën në rrugën e mesme të ekonomisë dhe të moralit më të lartë e të ndritur. Duke i përmirësuar gabimet e njeriut, atë e lartëson në vende të larta.

Orientalisti SEDIO

●

Kur'ani është një zë i Pejgamberit a.s.m. që mund ta dëgjojë e gjithë bota. Jehona e saj tingëllon nëpër saraje, shkretëtira, qytete dhe shtete!..

Kur'ani a është poemë? Nuk është i tillë, por është e vështirë ta dallosh nga poema sepse është më lart se ajo. Në këtë mënyrë Kur'ani nuk është libër historie, apo një përmbledhje e gjendjes së sotme, apo një varg këshillash si ata që ka mbajtur Isai (a.s.) në mal. Kur'ani nuk i ngjan as mësimëve budiste, apo librave të japin mësim logjike, apo të Platonit që cilat kanë dhënë këshilla. Ky është zëri i një profeti. Një zë i tillë që e gjithë bota mund ta dëgjojë. Jehonat e tij tingëllojnë edhe nëpër vila, edhe nëpër shkretëtira edhe nëpër qytete edhe nëpër shtete!... Feja që e ka formuar këtë zë, së pari ka gjetur shpallës të vet, shpirtëdashës të ndritur me ndërtesë të një jete të re. Nën hijen e kësaj feje, është formuar një dritë, prej bashkimit të Azisë me grekët, duke e çarë errësirën e Europës. Kjo ngjarje ka ndodhur në kohën kur të krishterët kanë përjetuar errësirën më të madhe, mesjetën.

Dr. JOHNSON

●

Kur'ani ka shpallur të vertetën e madhe për të besuar në njësimin e All-llahut xh.sh.. Ai është një e vërtetë botërore.

Autori i fjalorëve anglisht-arabisht dhe arabisht-anglisht, Doktor Sity Joungest thotë këto fjalë ndaj Kur'anit:

Kur'ani është libri më i dobishëm deri tani, që ka rënë në dorë të njerëzve. Sepse në këtë libër sqarohet imagjinata dhe cilësitë e një njeriu të madh.

Nuk ka gabuar fare Carlyle, i cili ka thënë se: Kur'ani është një libër ndërkombtar. Mendimi im në këtë drejtim është se drejtësia dhe përpjekja që ka bërë Muhammedi (a.s.m.) dhe sinqeritetin ndaj hulumtimeve të vërteta, atë e ka arritur vetëm me besim dhe zell të pasosur. Vetëm këto cilësi janë që ndaj atyre që nuk kanë dashur t'i dëgjojnë të vërtetat, me qëndrueshmërinë më të madhe i ka sjellur t'i dëgjojnë të vërtetat që i ka falur. Unë them se këto suksese atij ia ka sjellur vetëm shkaku se është vula e profetëve. Kur'ani është një përmbledhje e përsosur e besimit dhe moralit. Ai i udhëzon nga errësira në rrugë të drejtë. Sepse themeli i të gjitha këtyre cilësive të bukura, është tek besimi në një Zot xh.sh., i cili ka në dorë fatin e të gjitha qenieve. Kur'ani, njeriun duke e ngritur tek e vërteta me e lartë e besimit, pra në besimin tek një Zot i vetëm, me shprehjet e larta të Tij, tregon se mban me vete edhe gojtarinë e pastër dhe të paarritshme. Kur'ani duke sqaruar meritat e shpërblimit të atij që nënshtrohet dhe ndëshkimin e atij që kundërshton, pëlqen rrugën ndikuese që imagjinata e njeriut nuk e koncepton dot. Kështu edhe kur dëshiron të kritikojë, i trembë ato me gjendjet e profetëve të tjerë, popujt e të cilëve janë futur në rrugë të mëkateve dhe si rezultat kanë marrë dënimet e merituar. Këto Kur'ani i shpreh me seriozitet të plotë. Ne shohim se Kur'ani fiset dhe popujt armiq që kanë luftuar njëri me tjetrin, i ka bashkuar, i ka sjellur në gjendjen e popullit shembullor dhe nga mendimet e prapambetura ka bërë të arrijnë në një pozitë shumë të lartë. Duke parë këto virtyte do ta pranojmë se Kur'ani po mban me vete gojtari të madhe. Sepse kjo gojtari e Tij është një shkak që fiset e egra i ka ngritur në qytetërime në historinë e botës së vjetër, duke i shtuar një fuqi të re. Meqenëse vendet ashtu edhe kohërat, nga njeri-tjetri kanë qenë shumë larg edhe mendimet e tyre kanë marrë kultura të drejttimeve të ndryshme, por këto njerëz kanë arritur të jetojnë drejtëpeshime. Këtë e pranojnë edhe kundërshtarët e tyre, shkaku i kësaj është libri më i famshëm, Kur'ani, i cili meriton urime të zjarra. Kur'ani i famshëm është një bazë e rëndësishme dobiprurëse, për ato të cilët hulumtojnë dhe merren me studime, për përmirësimin e gjendjes së shoqërisë, pra sociologët.

Doktor CITY YOUNGEST



Nga pikëpamja e pastërtisë dhe gojtarisë, Kur'ani është një libër i pashoq. Në vetvete ai është një mrekulli madhështore.

Megjithëse gjatë përkthimit të Kur'anit ka kritikuar me fanatizëm përsëri Corsele ka deklaruar:

Kur'ani është një libër i argumentuar dhe i përsosur i gjuhës arabe. Në besimin e muslimanëve këtë libër të mrekullueshëm nuk mund ta formojë lapsi i njeriut. Në të vërtetë Kur'ani gjithmonë ka bartur mrekullinë me vete, një mrekulli e tillë që e tejkalon mrekullinë e të ngjallurit të të vdekurit. Amshueshmëria e këtij libri është e mjaftueshme për të vërtetuar se është një libër qiellor. Muhammedi (a.s.m.), duke u mbështetur në mrekullinë e tij, është pranuar si profet. Kur'ani ka shndritur gadishullin arabik dhe i ka mposhtur oratorët, poetët dhe ekspertëve të tyre u ka kërkuar të shkruajnë të paktën vetëm një ajet të vetëm. Asnjëri s'ka guxuar t'i përgjigjet kësaj kërkesë. Kur t'iu parashtrij vetëm një shembull, do ta kuptoni se të gjithë njerëzit e mëdhenj, përpara Kur'anit kanë ulur kokën.

Në kohën e Hazreti Muhammedit (a.s.m.), poeti më i famshëm i të gjithë qyteteve të gadishullit, ka qenë Lebid, i cili ka qenë ekspert i një vjershe të posaçme, të cilat janë varur në muret e Qabes. Në atë kohë që Lebid i ka adhuruar idhujt, gojtarinë e Kur'anit e ka lavdëruar me fjalët më të bukura. Duke mbetur i habitur përpara Kur'anit, Lebid ka pranuar fenë Islame, duke thënë se këtë vetëm një Pejgamber mund ta flasë.

Kur'ani ka shprehur me gojtarinë më superiore dhe të rrjedhshme. Veçanërisht shumica e ajeteve që theksojnë madhërinë, ngadhënjimin dhe funksionet e All-llahut xh.sh., e kanë një bukuri të pashoqshme. Megjithëse jam përpjekur që ta përkthej Kur'anin, me siguri lexuesit e mi, do të konstatojnë se nuk kam mundur të mbroj origjinalitetin e Kur'anit, dhe gjithashtu megjithë gabimet që kam bërë në përkthim, përsëri lexuesit e mi do t'i shohin madhëritë e shumta të ajeteve.

CORSELE



Kur'ani për njerëzit është një dhuratë hyjnore, i cili ka arritur të formojë republika triumfale.

Prifti fanatik anglez Rodwell, i cili ka përkthyer dhe rregulluar ajetet Kur'anore, sipas kohëve të zbritjes së tyre, ka thënë se këto të vërteta nuk po mundet t'i mohojë:

Kur'ani endacakët e thjeshtë arabë, i ka bërë të tillë që kur t'i shihni do të imagjinoni se janë të magjepsur. Kur'ani ka shmangur dhe ka zhdukur adhurimin ndaj kryqeve, e forcon bindjen në një Zot të vetëm. Ai ka shmangur adhurimin ndaj xhindëve, gurëve dhe traditave të egra, si varrosjen e vajzave për së gjalli, të gjitha mitet i ka pastruar dhe martesën me shumë gra e ka kufizuar. Pra këto virtyte për të gjithë popujt arabë janë një dhunti dhe mirësi Hyjnore. Kur'ani ka merituar të gjitha lavdet, për arsye se ka vërtetuar

Krijuesin e gjithësisë që e di të fshehtë e të qartë dhe e ka lartësuar në vendin e duhur. Shprehjet e Kur'anit me frymëzime të forta, kanë shprehur të vërtetat e thella, kur fjalët kanë qenë në mënyrë të përmbledhur dhe lakonike. Kur'ani ndoshta nuk ka mundur t'i formojë atdhetë të vazhdueshëm, por ka argumentuar se është në gjendje t'i sjellë themelet, të cilat i shërbejnë republikave triumfale. Vetëm me principet e Kur'anit edhe popujt pa kulturë, që kanë vuajtur varfërinë e pafundme, banorët e një gadishulli të shkretë dhe të zhveshur, me temperaturën e fesë së re që ka zbritur, njerëzit e egër janë bërë besimtarë të sinqertë dhe kanë formuar shtete, kanë ndërtuar qytetërime. Në të vërtetë madhëria e muslimanëve është se Fesdadi, Bagdadi, Kordova, Delhi, etj., me forcën e një madhërie të tmerrshme e kanë dridhur të gjithë Europën.

RODWELL



Feja Islame me vete përmban kulturën botërore e cila u përgjigjet përparimeve dhe të gjitha nevojave të botës.

Gaston Care, orientalist i famshëm francez, në vitin 1913 në gazetën "Figaro", në vargun e shkrimeve ka marrë si temë që po qe se do të zhduket muslimanizmi, a do të jetë e mundur të mbrohet mirëqenia. Në atë kohë gazetat e Lindjes e kanë përkthyer këtë pjesë.

"Qindra mijëra njerëz që kanë pranuar fenë Islame, janë të bindur se kjo fe është e përshtatshme për jetesën e kësaj bote. Principi dhe burimi i kësaj feje që është Kur'ani, përmban shtyllat themelore të botës, për derisa qytetërimi botëror mbështetet tek themelet që ka shpallur feja Islame. Në të vërtetë kjo fe e lartë, Europës i ka garantuar burimet e ndërtesës së zbulimeve. Duke ua dhënë hakun e lartësisë fesë Islame, ende nuk pranojmë se duhet t'i falenderojmë huadhënësit. Nuk duhet dyshuar se e vërteta është e tillë".

Gazetari francez në vazhdim duke theksuar se Kur'ani i ka shërbyer paqes së përgjithshme, thotë se:

"Po qe se feja Islame zhduket nga faqja e dheut dhe nuk mbetet asnjë musliman, a është e mundur të përjetohet paqja? Kurrë!... Kjo është e pamundur."

Gaston CARE



Kur'ani është përmbi të gjitha librat.

Dijetari i famshëm orientalist Jochahim Durulph, duke treguar rëndësinë që i ka dhënë Kur'ani shëndetit, thotë:

"Do t'iu tregoj një nga virtytet e fesë Islame, që deri tani nuk ka tërhequr pikësynimin e asnjë autori europian. Në këtë fazë të fesë Islame, do ta kuptoni se si i urdhëron njerëzit

të ruajnë shëndetin. Së pari duhet të pranojmë se urdhërat e Kur'anit, në këtë mënyrë janë përmbi të gjithë librat e tjerë. Po qe se marrim parasysh principet që ka parashtruar Kur'ani, megjithëse do të vëmë re se në dukje janë principe të thjeshta, në realitet ato janë të përsosura. Kështu që kur ta marim ta hulumtojmë, do të shohim se në hije të këtij libri të amshueshëm, së bashku me disa pjesë të botës, vendet e Azisë janë një grumbullim insektesh dhe kandërrash. Por feja Islame muslimanëve duke ua bërë farz pastërtinë, i ka shkatërruar mikrobet.

JOCHAHIM



Ajetet e Kur'anit janë si një kordon artesh në trupin e fesë Islame.

Libri në gjuhën angleze i titulluar “Sembires Encyclopedia”, në pjesën e diturisë së gjerë, jep lajme për Islamin:

Ajetet e Kur'anit që kanë shndritur cilësitë e Muhammedit, mbanin përsosmërinë dhe ndikimin e pafundëm. Këto ajete njoftojnë principet e moralit të fesë Islame. Gjithashtu këto principe nuk përbëhen vetëm në një apo dy sure të Kur'anit. Ndoshta ajetet e Kur'anit janë si një kordon artesh në trupin e fesë Islame. Pasjellshmëria, gënjeshtria, ambicja, shpenzimet e kota, prostitucioni, tradhëtia dhe gijbeti (përgojimi), nga ana e Kur'anit, të gjitha këto kritikohen tmerrshëm dhe konsiderohen si skandal poshtërsirash. Nga ana tjetër këshillon çdo njeri të ketë qëllime të mira, të bëhet bamirës, nderimbërës, i turpshëm (nga veprat e pamoralshme), tolerant, durimtar, ekonomist, i drejtë, real, pajtues dhe anues nga e vërteta. Ai kërkon t'i besosh dhe t'i jesh i bindur All-llahut xh.sh. më shumë se të tjerëve dhe t'i nënshtrohesh urdhërave të Tij. Këto virtyte në pikëpamjen e besimtarit konsiderohen si themele të besimit të vërtetë dhe janë cilësitë e një besimtari. I dërguari fisnik ka qenë shembullor i logjikës dhe i vetëdijes.

Profesor Eduard Monte, në faqen 17-18 të librit të tij që titullohet “Përhapja e krishtërizmit dhe armiku i tyre muslimanët”, thotë:

Racionalizmi, d.m.th. po qe se mundemi ta zgjerojmë dobishmërinë dhe rëndësinë e tij historike të fjalës së logjikshmërisë, atëherë do ta shohim se feja Islame nuk është një fe jashtë logjikës. Sepse studentët me peshoren e mendjes dhe të logjikës, kur peshojnë bindjen në fe, pa dyshim do ta pranojnë se fjala “racionalizëm”, pa fare dallim është e përshtatshme me fenë Islame. I dërguari fisnik është shembullor në mendime dhe përsëri do të bindet se atë e kanë shndritur dritat e besimit. I dërguari fisnik me të njëjtin zjarr ata i ka entuziasmuar edhe ata që kanë përjetuar shekullin e tij, i ka pajisur me cilësitë që ka përjetuar. Hazreti Muhammedi (a.s.m.) kur ka dashur të bëjë suksese në thirrjen e tij, Kur'anin e famshëm e ka paraqitur si revelatën e Zotit xh.sh., pra një revelatë hyjnore. Në këtë mënyrë feja e Hazreti Muhammedit a.s.m. plotësisht ka qenë e përshtatshme me logjikën e mendjes. Kështu që, sipas besimit të muslimanëve bindshmëria e tyre në këto principe përmblihet:

Muhammedi (a.s.m.) është Profeti i All-llahut xh.sh.. Me të vërtetë me vëmendje kur t'i hulumtojmë themelet e besimit Islam, e tillë na del përpara.T'i besosh njësimi të All-llahut xh.sh., dërgueshmërisë së Muhammedit (a.s.m.), ringjalljes pas vdekjes, në këtë mënyrë do të shohim se me këto bindje që rreshtuam, gjen fund besimi i muslimanëve. Pra vetëm këto dy themele në të cilët njihet bindja, të gjitha këto besimtarët i pranojnë si të logjikshme dhe të gjitha këto janë përmbledhur në Kur'anin e famshëm. Shprehjet e Kur'anit janë të pastëra të qarta dhe ka arsyetuar përhapjen dhe lartësimin e fesë Islame në mënyrë të pandërprerë. Këtu shumë qartë po shohim se sa janë të lidhur muslimanët me Kur'anin. Gjithashtu dërgueshmëria e Pejgamberit (a.s.m.) është vërtetuar dhe pranuar nga ana e besimtarëve, si mesazh i amshueshëm. Përsëri Kur'ani është bërë burim i frymëzimit dhe pikëmbështetje e muslimanëve. Gjuha e amshuar që i ka bindur muslimanët është vetëm Kur'ani Famëlartë, gjë që asnjë libër Atë s'mund ta arrijë kurrë. Kur'ani i përsosur zotëron një fuqi të padukshme dhe feja islame për hulumtimin e secilit që është i hapur; me të vërtetë, zotëron një mrekulli të posaçme. Dhe nuk ka dyshim që feja Islame e zotëron këtë fuqi, për të tërhequr njerëzit nga vetja.

Edward MONTE